

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 7009  
E shtunë, 30 shtator 2023  
Çmimi 0.50

Osmani takohet me  
ambasadorët e Quintit  
dhe të BE-së: Të kërkohet  
llogaridhënie nga Serbia ■ FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I NATO-S, JENS STOLTENBERG,  
DEL ME DEKLARATË PËR SITUATËN NË VERI TË KOSOVËS ■ FAQE 4

## NATO-ja DËRAGON FORCA SHITESË PËR SHKAK TË TENSIONEVE NË VERI TË KOSOVËS

- Sekretari i  
përgjithshëm i NATO-s:  
Të shpërkallëzohet  
situata në veri, palët të  
angazhohen në dialog



NATO-ja ka njoftuar të premten se ka miratuar forca shtesë për t'i dislokuar në veri të Kosovës për shkak të rritjes së tensioneve si pasojë e sulmit terrorist të 24 shtatorit. Me këtë rast, sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens

Stoltenberg, ka kërkuar të shtensionohet situata në veri. Ai u ka bërë thirrje Kosovës dhe Serbisë të angazhohen në dialog. "Vazhdojmë t'i bëjmë thirrje Beogradit dhe Prishtinës që të angazhohen në dialogun e lehtësuar nga BE-ja, pasi

është mënyra e vetme për t'i zgjidhur çështjet e pazgjidhura", ka thënë ai. Pavarësisht prej kësaj, Stoltenbergu ka deklaruar se NATO është e gatshme ta risë praninë e trupave të KFOR-it nëse shfaqet nevoja për këtë

### OPINION

ALEKSANDËR VUÇIQI,  
KOMANDANT I PAAFTË,  
FRIKACAK DHE KRIMINEL F.7

Shkruan:  
Prof. dr. Kudusi  
LAMA, gjeneral në  
pension



### AKTUALE



KURTI: PAS SULMIT TERRORIST NË  
VERI NDOHTA QËNDRON MOSKA F.7

NDËRRON JETË SENATORJA  
AMERIKANE QË KISHTË VOTUAR  
PËR BOMBARDIMIN E SERBISË F.6

NËNSHKRUHET PROTOKOLLI PËR  
NDËRTIMIN E RRRUGËVE TË REJA QË  
NDËRLIDHIN FSHATRA TË KUFIRIN  
KOSOVË - SHQIPËRI F.6

### EKONOMI



SHAHINI TAKOHET ME KRYETARIN E  
ODËS AFRIKË - BALLKAN, PAJTOHEN  
PËR BASHKËPUNIM EKONOMIK F.8

KRAHASUAR ME VITIN E KALUAR,  
RRITET NUMRI I VIZITORËVE NË  
HOTELE GJATË GUSHTIT 2023 F.8

### SPORT

SOT PËRBALLJA E DY SKUADRAVE  
KRYESUESE BALLKANI - LLAPI F.10

## POLICIA BASTIS PRONAT E RADOIÇIQIT NË VERI



## PËR ASOCIACIONIN, SYTË KAH SHBA-ja



**RENOVA**  
PUTZ  
Mqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mbx: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Zelensky dhe Navalny, ndër pretendentët për çmimin Nobel për paqe

Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky dhe aktivisti rus, Alexei Navalny, janë në garë për Çmimin Nobel të Paqes të këtij viti. Vendimi i takon Komitetit Norvegjez të Nobelit, i përbërë nga pesë anëtarë të zgjedhur nga Parlamenti norvegjez. Mes 351 të nominuarve, Zelensky dhe Navalny janë

të preferuarit, por ekspertët kanë thënë se shanset e tyre janë të pakta, veçanërisht pasi Zelensky është një udhëheqës në një kohë luftë dhe fokusi i komitetit në Rusi vitin e kaluar ndikon në shanset e të dy burrave. Lista e plotë e kandidatëve mbetet sekrete, por emrat e zbuluar përfshijnë ambientalisten Greta

Thunberg, kreun e opozitës ruse, Vladimir Kara-Murza dhe protestuesin kinez Peng Lifa. Laureati merr jo vetëm një medalje dhe diplomë, por edhe 11 milionë korona suedeze (afërsisht 812 306£). Fituesi do të shpallet zyrtarisht më 6 tetor, me ceremoninë e planifikuar me 10 dhjetor në bashkinë e Oslos.



## Republikanët nisin procesin hetimor për shkarkim të Bidenit



WASHINGTON, 29 SHTATOR - Republikanët në Dhomën e Përfaqësuesve në Shtetet e Bashkuara e kanë cilësuar të suksesshme ditën e parë të hetimeve për shkarkim të presidentit amerikan Joe Biden. Mirëpo ekspertët, që kanë qenë dëshmitarë të rastit të iniciuar nga republikanët, kanë thënë se ende nuk ka mjaftueshëm dëshmi për shkarkim. Udhëheqësi i Dhomës së Përfaqësuesve, Kevin McCarthy, ka thënë se hetimet lidhen me dyshimet se Hunter Biden është përfshirë në aktivitete të palakueshme biznesore, nga të cilat ka përfituar presidenti.

Hetimet zyrtare për shkarkim u mundësojnë ligjvënësve që të kenë më shumë autoritetet për të hetuar ndonjë sjellje të keq eventuale. Në seancën e parë ka qenë Hunter Biden dhe jo presidenti që e ka fituar vëmendjen më të madhe. Republikani James Comer ka thënë se paneli do të hetojë "dhjetëra dëshmi", përfshirë emaila dhe të dhëna bankare, të cilat, sipas tij, vërtetojnë "korrupsionin dhe abuzimin" e Joe Bidenit dhe pozitën zyrtare. "Të paktën 10 herë Joe Bideni e ka gënjyer popullin amerikan se nuk ka folur kurrë me familjen e

tij për aktivitetet e tyre biznesore", ka thënë ai. Ai ka thënë se do të lëshojë urdhra që detyrojnë Hunter Bidenin dhe vëllanë e presidentit, James, që t'i publikojnë dokumentet bankare për të ardhurat e tyre. Hetimet për shkarkim mund të zgjasin me javë. Ende është shumë herët për të kuptuar nëse hetuesit e Kongresit do të kërkojnë votim në Kongres për shkarkim të Bidenit, pas përfundimit të seancave. Ndaras Hunter Biden është akuzuar penalisht për tri shkelje, përfshirë atë se ka gënjyer kur e ka blerë një armë.

## BE-ja pa konsensus për migracionin, Gjermania dhe Italia përplasen për propozimet kryesore

BRUKSEL, 29 SHTATOR - Njëzet e shtatë vendet anëtare të Bashkimit Evropian (BE) nuk kanë rënë dakord për ndryshimin e Ligjit për Emigracionin, pasi Gjermania dhe Italia janë përplasur mbi propozimet kryesore në lidhje me garancitë e të drejtave të njeriut në qendrat e paraburgimit dhe rolin e organizatave joqeveritare në lehtësimin e ardhjes së emigrantëve. Referuar burimeve të cituara nga mediet ndërkombëtare, Gjermania ka kundërshtuar një pikë të re, të mbështetur nga Italia, që do ta lejonte shkeljen e standardeve minimale në qendrat e paraburgimit në rrethana të jashtëzakonshme. Nga ana tjetër,



qeveria e ekstremit të djathtë të Italisë ka kundërshtuar një

klauzolë, të cilën Berlini e ka mbështetur në lidhje me

emigrantët e ndihmuar nga OJQ-të për të arritur në një vend të BE-

së. Edhe pse takimi ka përfunduar pa asnjë rezultat, ministrat kanë thënë se prishin se gjatë ditëve në vijim do të formohet një pakt që do të zbatohet në rast të një krize të papritur refugjatësh si ajo e vitit 2015, kur më shumë se 1 milion njerëz, kryesisht nga Siria, kanë hyrë në territorin e BE-së. Diskutimi është zhvilluar në mes të një rritje të numrit të njerëzve që mbërrinin në Itali nga Tunizia si dhe mbërritjeve në ishujt grekë të Samos dhe Lesbos. Në fillim të këtij viti BE-ja ka rënë dakord për ta lejuar zhvendosjen e emigrantëve nëpër Evropë dhe gjoba prej 20 mijë eurosh për vendet që refuzuan të marrin pjesën e tyre të caktuar.

## Orbani kundër Ukrainës në BE: S'ka negociata me një vend që është në luftë

Budapest, 29 shtator - Kryeministri i Hungarisë, Viktor Orbani, ka thënë të premten se "çështjet shumë të vështira" duhet të marrin përgjigje përpara se Bashkimi Evropian t'i fillojë bisedimet për anëtarësimin e Ukrainës. Vendet e BE-së do të vendosin në dhjetor nëse do ta lejojnë

Ukrainën t'i fillojë negociatat e pranimit, të cilat do ta kërkonin mbështetjen unanime të të 27 anëtarëve. Diplomtat kanë thënë se Hungaria mund të jetë një pengesë. "Ne nuk mund ta shmangim pyetjen, kur gjatë vjeshtës t'i fillojmë negociatat në Bruksel për të ardhmen e

Ukrainës nëse mund ta shqyrtojmë seriozisht mundësinë e bashkimit me një vend dhe t'i fillojmë bisedimet e anëtarësimit të një vendi që është në luftë. Ne nuk e dimë sa i madh është territori i këtij vendi, pasi lufta vazhdon ende. Nuk e dimë se sa është popullsia e tij, pasi po

largohet. Duke pranuar një vend në BE pa i ditur parametrat e tij, kjo do të ishte e paprecedentë. Pra, unë mendoj se ne duhet t'u përgjigjemi pyetjeve shumë të vështira derisa të vendosim në të vërtetë për fillimin e bisedimeve të anëtarësimit", ka thënë Orbani.



SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I NATO-S, JENS STOLTENBERG,  
DEL ME DEKLARATË PËR SITUATËN NË VERI TË KOSOVËS

# NATO-ja dërgon forca shtesë për shkak të tensioneve në veri të Kosovës

- Sekretari i përgjithshëm i NATO-s: Të shpërshkallëzohet situata në veri, palët të angazhohen në dialog

NATO-ja ka njoftuar të premtën se ka miratuar forca shtesë për t'i dislokuar në veri të Kosovës për shkak të rritjes së tensioneve si pasojë e sulmit terrorist të 24 shtatorit. Me këtë rast, sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka kërkuar të shtensionohet situata në veri. Ai u ka bërë thirrje Kosovës dhe Serbisë të angazhohen në dialog. "Vazhdojmë t'i bëjmë thirrje Beogradit dhe Prishtinës që të angazhohen në dialogun e lehtësuar nga BE-ja, pasi është mënyra e vetme për t'i zgjidhur çështjet e pazgjidhura", ka thënë ai. Pavarësisht prej kësaj, Stoltenbergu ka deklaruar se NATO është e gatshme ta rrisë praninë e trupave të KFOR-it nëse shfaqet nevoja për këtë



EPOKA ERE

Lirim GEÇI

**BRUKSEL, 29 SHTATOR** - Këshilli i NATO-s është mbledhur të premtën për të diskutuar për situatën në Kosovë. Pas kësaj mbledhjeje, NATO-ja ka njoftuar se ka miratuar forca shtesë për t'i dislokuar në veri të Kosovës, zonë e banuar me shumicë serbe, për shkak të rritjes së tensioneve. "Ne gjithmonë do të sigurojmë që komandanti ynë t'i ketë burimet dhe fleksibilitetin e nevojshëm në mënyrë që KFOR-i (Misioni i NATO-s në Kosovë) ta përmbushë mandatin e tij", ka thënë nëpërmjet një deklarate sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg. Po ashtu, ai u ka bërë thirrje

Kosovës dhe Serbisë të rikthehen në tavolinën e negociatave në Bruksel. "U bëjmë thirrje të gjitha palëve që urgjentisht ta shpërshkallëzojnë situatën. Ne vazhdojmë t'u bëjmë thirrje Beogradit dhe Prishtinës që të angazhohen në dialogun e lehtësuar nga BE-ja, pasi është mënyra e vetme për t'i zgjidhur çështjet e pazgjidhura dhe për të arritur zgjidhje që respektojnë të drejtat e të gjitha komuniteteve. Ky është çelësi për sigurinë e qëndrueshme në Kosovë dhe stabilitetin në rajon", është thënë në deklaratën e Stoltenbergut.

Në deklaratën e Stoltenbergut është thënë se misioni i KFOR-it ka një prani të dukshme në mbarë Kosovën. "Ne gjithmonë do t'i ndërmarrim të gjitha veprimet e

nevojshme për të ruajtur një mjedis të sigurt dhe të sigurojmë lirinë e lëvizjes për të gjithë njerëzit që jetojnë në Kosovë. Ne e bëjmë këtë në mënyrë të paanshme dhe në përputhje me mandatin tonë të OKB-së", është thënë në këtë deklaratë.

Edhe ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Jeffrey Hovenier, ka thënë më 26 shtator se ShBA-ja vazhdon të kërkojë nga Kosova dhe Serbia të angazhohen në mënyrë aktive në dialogun e ndërmjetësuar nga BE-ja. "ShBA-ja vazhdon të kërkojë nga Kosova dhe Serbia të angazhohen në mënyrë aktive në dialogun e

ndërmjetësuar nga BE-ja jo për të negociuar zotime dhe marrëveshje të reja, sepse e kemi një marrëveshje të mirë dhe një aneks të mirë të zbatimit, por ta arrijmë zbatimin e plotë nga të dyja palët për këtë marrëveshje... Ne duam të shohim që marrëveshja e Ohrit të zbatohet plotësisht nga të dyja palët", ka thënë Hovenieri. Edhe nga Bashkimi Evropian (BE) kanë kërkuar që Kosova dhe Serbia t'i rikthehen dialogut. Kujtojmë se më 24 shtator Policia e Kosovës është sulmuar në Banjskë të Zveçanit teksa po kryente një operacion për heqjen e një barrikade të vendosur në rrugë. Si

pasojë e sulmit ka mbetur i vrarë rreshteri Afrim Bunjaku dhe janë plagosur disa policë të tjerë. Sulmuesit e dyshuar, që sipas autoriteteve në Kosovë ishin rreth 30, janë strehuar në manastirin e Banjskës dhe prej aty kanë vazhduar përlëshjet me policinë. Tre sulmues të dyshuar kanë mbetur të vrarë gjatë shkëmbimit të zjarrit, ndërsa katër persona janë arrestuar për këtë sulm, që Kosova është duke e cilësuar terrorist dhe për të e ka fajësuar Serbinë. Gjatë aksionit në veri policia ka konfiskuar sasi të madhe të armatimit, vlera e të cilit llogaritet të jetë 5 milionë euro.

## Osmani takohet me ambasadorët e Quintit dhe të BE-së: Të kërkohej llogaridhënie nga Serbia

**PRISHTINË, 29 SHTATOR** - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka takuar të premtën ambasadorët e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Britanisë së Madhe, Gjermanisë, Francës, Italisë dhe të Bashkimit Evropian (BE), për të diskutuar për situatën aktuale në veri të vendit pas sulmit terrorist dhe aktit të agresionit të Serbisë kundër Republikës së Kosovës. Në këtë takim, presidentja Osmani i ka falënderuar ambasadorët për solidaritetin dhe ngushëllimet e shprehura për vrasjen e heroit të Kosovës, rreshterit të Policisë së Kosovës,



Afrim Bunjakut, si dhe lëndimit të disa policëve të tjerë. Ajo e ka vlerësuar lart punën e shkëlqyeshme dhe profesionale të Policisë së Kosovës dhe institucioneve të tjera të sigurisë

për ballafaqim me sulmin terrorist. Presidentja Osmani ka theksuar rëndësinë e bashkëpunimit të ngushtë me shtetet aleate dhe koordinimin e institucioneve të sigurisë me qëllim të parandalimit të përsëritjes së akteve të tilla. "Kosova është e vendosur që të vazhdojë ta promovojë paqen dhe stabilitetin në rajon, si dhe të punojë me komunitetin lokal serb për t'i afruar dhe integruar në shoqërinë dhe institucionet e Kosovës", ka theksuar Osmani. Presidentja Osmani ka bërë me dije se institucionet e Republikës

së Kosovës janë të përkushtuara për menaxhimin e situatës aktuale dhe për të ndihmuar në arritjen e ruajtjen e paqes dhe stabilitetit. Sipas presidentes Osmani, duhet të kërkohej llogaridhënie nga Serbia për veprimet e saj kundër Kosovës, duke ia bërë të qartë se duhet ta ndalojë financimin, mbështetjen dhe shtytjen e grupeve kriminale për veprime terroriste. "Mungesa e masave të tilla mund të keqpërdoret nga ana e Serbisë dhe, për rrjedhojë, mund të kemi përsëritje të veprimeve terroriste", ka nënvizuar Osmani.

# Policia bastis pronat e Radoiçiqit në veri

PRISHTINË, 29 SHTATOR - Policia e Kosovës ka kryer të premtën kontrollë në pesë lokacione në tri komuna në veri të Kosovës: Mitrovicë e Veriut, Zveçan dhe Zubin Potok, lidhur me sulmet ndaj Policisë së Kosovës më 24 shtator në Banjskë të Zveçanit. Si pasojë e përlëshjeve të policisë me një grup të armatosur në këtë pjesë në veri të Kosovës - të banuar me shumicë serbe - është vrarë një zyrtar policor dhe tre sulmues.

Prokurori special i angazhuar në këtë rast, Naim Abazi, ka thënë se aksioni policor i së premtes është zhvilluar kryesisht në pronat që janë evidentuar si prona të të dyshuarit Millan Radoiçiq. Pjesëtarët policorë në Mitrovicë të Veriut kanë qenë edhe të spitali i qytetit. Aty hetuesit kanë kërkuar që të kontrollohet një aneks ku gjendet ngrohtorja. Drejtori i spitalit, Zlatan Ellek, ka konfirmuar për mediet se policia i ka konfiskuar incizimet monitoruese dhe nuk ka gjetur asgjë tjetër të dyshimtë. Zyrtarët policorë kanë qenë edhe të restoranti "Gray" në Mitrovicën e Veriut, i cili besohet se është në pronësi të Ema Radoiçiqit, bashkëshortes së nënkryetarit të Listës Serbe, Millan Radoiçiq. Mediumi serb "Kossev" ka raportuar se në garazh të këtij lokali janë konfiskuar disa vetura, dy prej të cilave me targa të Beogradit dhe një pa targa fare. Ndërsa prokuroria ka bërë me dije se gjatë bastisjeve ka sekuestruar si prova materiale:



dy vetura të llojit "Mercedes", dy motorë 4x4, një barkë (anije), dy pllaka antiplumb dhe dy mbrojtëse, pesë gëzhoja, një dron, thika, një shënjestër dhe pajisje të tjera elektronike, sikurse shtatë telefona celularë, kamerë "GoPro", një videokamerë, USB, ruterë etj. Policia ka thënë se kontrollët i ka kryer në koordinim me misionin e Bashkimit Evropian për sundim të ligjit, EULEX dhe misionin e NATO-s në Kosovë, KFOR.

Lista Serbe, partia kryesore e serbëve në Kosovë, ka thënë se njësitet speciale të Policisë së Kosovës kanë hyrë brutalisht në spitalin në Mitrovicë të Veriut dhe i ka akuzuar zyrtarët policorë për "brutalitet të tepruar".

Në një komunikatë për medie, kjo parti, e cila e gëzon mbështetjen e Beogradit zyrtar, ka thënë se kryeministri i

Kosovës, Albin Kurti, është duke i shfrytëzuar zhvillimet në Banjskë "për t'i justifikuar të gjitha aktivitetet antiserbe në Kosovë dhe Metohi, si dhe për ta vazhduar keqtrajtimin e mëtejshëm të qytetarëve tanë". Ndërsa e ashtuquajtura Zyrë për Kosovën në Qeverinë e Serbisë ka thënë se policia e ka dëmtuar derën hyrëse të spitalit dhe ka pretenduar se nga aksioni policor janë shqetësuar banorët e zonës.

Si Lista Serbe ashtu edhe e ashtuquajtura Zyrë për Kosovën në Qeverinë e Serbisë e kanë kritikuar, siç kanë thënë ato, mosreagimin e EULEX-it në aksionin policor.

Millan Radoiçiq, nënkryetar i Listës Serbe - partisë më të madhe të serbëve në Kosovë - është akuzuar nga autoritetet e Kosovës se ka organizuar dhe ka qenë pjesë e sulmeve ndaj policisë në Banjskë. Ministri i

## Radoiçiqi merr përgjegjësinë për sulmin terrorist në Banjskë dhe jep dorëheqje nga nënkryetari i Listës Serbe

Millan Radoiçiqi e ka pranuar se ka qenë në fshatin Banjskë të Zveçanit më 24 shtator dhe se i ka bërë të gjitha përgatitjet logjistike për ngjarjet e asaj dite. Ai e ka bërë këtë deklaratë përmes një letre të lexuar nga avokati i tij, Goran Petronijević, për publikun nga Beogradi. "Po i njoftoj të gjithë persekutorët vigjilentë të popullit serb, prej Kurtit e te ndihmësit e tij të shumtë të huaj, se unë personalisht i kam bërë të gjitha përgatitjet logjistike për mbrojtjen e popullit tonë kundër pushtuesit dhe ky akt imi nuk ka asnjë karakter apo qëllim tjetër, dhe nuk ka të bëjë fare me të kaluarën time", ka thënë ai, duke iu referuar kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti. Avokati, duke e lexuar letrën e Radoiçiqit, ka thënë se për

veprimet e tij Radoiçiqi nuk e ka njoftuar askënd prej strukturave qeveritare serbe apo atyre politike lokale në veri të Kosovës, as nuk e ka pranuar "ndonjë ndihmë" prej tyre. Radoiçiqi ka thënë se me ta ka pasur qëndrime të ndryshme në lidhje me "metodat e mëparshme të rezistencës ndaj terrorit të Kurtit" dhe se atyre u është kërkuar "të tërhiqen pa arritur ndonjë rezultat të dukshëm".

Në letër Radoiçiqi ka theksuar se vrasja e policit të Kosovës ka qenë "aksidentale", pas së cilës ka nisur "një përlëshje e ashpër nga të dyja palët".

Ai e ka njoftuar opinionin se po jep dorëheqje nga pozita e tij në Listën Serbe, duke theksuar se përfshirja e tij politike në Listën Serbe "nuk kishte të bënte me kthimin e tij në Kosovë".

Brendshëm i Kosovës, Xhelal Sveçla, e ka publikuar një pamje me dron, duke thënë se njëri prej burrave - që shihet i veshur me uniformë me armë në dorë - ka qenë vetë Radoiçiqi.

Kuvendi i Kosovës e ka miratuar të enjten një rezolutë, e cila e dënon sulmin në Banjskë dhe përmend nevojën e një hetimi ndërkombëtar për Serbinë dhe rolin e saj në këtë sulm.



## Hoti: Hetimi për sulmin terrorist në veri duhet të shtrihet edhe në Serbi

PRISHTINË, 29 SHTATOR - Ish-kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka thënë se është shumë e rëndësishme që krahas hetimit për sulmin terrorist, të normalizohet jeta e qytetarëve në komunat në veri. Sipas tij, këto hetime duhet të jenë shumë profesionale dhe në bashkëpunim me ndërkombëtarët. Në këtë kontekst, Hoti ka kërkuar që hetimi për sulmin terrorist në

veri duhet të shtrihet edhe në Serbi. "Hetimet e institucioneve të Kosovës lidhur me sulmin terrorist të 24 shtatorit duhet të jenë shumë profesionale e të kujdesshme, si dhe në koordinim të ngushtë me institucionet ndërkombëtare të sigurisë që janë të vendosura në Kosovë. Hetimi sigurisht se duhet të shtrihet edhe në Serbi si pjesë e një hetimi ndërkombëtar që

duhet të ndërmerret për këtë sulm. Është shumë e rëndësishme që, paralelisht me këto hetime, të punohet për normalizim të shpejtë të jetës së përditshme në ato komuna. Në këtë drejtim duhet të vendoset komunikim i ngushtë me komunitetin serb në çdo lokalitet përmes këshillave lokale për t'i mbajtur të informuar dhe për t'i siguruar se do ta kenë mbrojtjen e nevojshme.

Qytetarëve atje e kemi për obligim t'u krijojmë ambient të sigurt që t'i dërgojnë fëmijët në shkollë, t'i kryejnë obligimet e tyre familjare e të punës, si dhe të lëvizin lirshëm. Pikat kufitare duhet të hapen sa më parë dhe të normalizohet qarkullimi, por edhe të sigurohet mbikëqyrje e plotë e vijës kufitare nga ana e KFOR-it. Ndërkaq, zgjidhja e përhershme afatgjatë në veri duhet të jetë politike, përmes



dialogut, dhe në koordinim të plotë me aleatët euroatlantikë, në veçanti ShBA-në", ka shkruar Hoti.

# Për Asociacionin, sytë kah ShBA-ja

Presidentja Vjosa Osmani ka propozuar që Kosova duhet të ulet me ShBA-në për ta hartuar draftin e Asociacionit. Ky propozim i Osmanit deri më tani nuk është komentuar nga ShBA-ja. Pavarësisht thirrjes së saj, Edward P. Joseph, ligjërues në "Johns Hopkins", ka thënë se propozimi i presidentes Osmani është "mjaft i zgjuar". Sipas tij, Kosova është duke e shfrytëzuar levën që i ka dhënë sulmi katastrofik në Banjškë të Zveçanit. Ndërsa Leon Hartwell, bashkëpunëtor i lartë në Shkollën e Londrës për Ekonomi dhe Shkenca Politike, ka thënë se nuk parashikon ndonjë ndryshim të madh në qasjen e ShBA-së ndaj dialogut Kosovë - Serbi.

**PRISHTINË, 29 SHTATOR** - Topi për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë do të duhej të kalonte në fushën e ShBA-së së paku sipas presidentes së Kosovës, Vjosa Omani.

E para e shtetit ka thënë në një intervistë për Radio Televizionin e Kosovës (RTK) se ShBA-ja do të duhej të merrte rol udhëheqës në bisedimet për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi.

Këtë rol tash e dymbëdhjetë vjet e ka Bashkimi Evropian. "Mendoj se zgjidhja është si vijon: Ne duhet të ulemi me ShBA-në dhe ta përgatitim draft-statutin e Republikës së Kosovës", ka thënë Osmani, duke iu referuar Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe.

As BE-ja, as Ambasada Amerikane në Prishtinë nuk u janë përgjigjur kërkesave të "Radios Evropa e Lirë" për ta komentuar këtë deklaratë.

"REL"-i ka kërkuar nga Presidencia e Kosovës më shumë sqarime për të, por, ngjashëm, nuk ka marrë përgjigje.

Nga Qeveria e Kosovës kanë thënë se sikurse edhe në të kaluarën, e mirëpresin interesimin dhe përfshirjen në formë të ndryshme të ShBA-së në procesin e dialogut. "Por, gjithsesi i takon ShBA-së ta përcaktojë nivelin dhe formën e rolit dhe të përfshirjes në këtë proces", ka thënë zëdhënësi i qeverisë, Përparim Kryeziu.

Sipas disa njohësve të zhvillimeve në Kosovë, propozimi i presidentes Osmani është "i zgjuar".

Për Asociacionin, Kosova dhe Serbia kanë arritur marrëveshje në vitin 2013 - në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve - por ajo nuk është zbatuar kurrë. Në vitin 2015 palët janë pajtuar për parimet e tij, por po atë vit Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka gjetur se një pjesë e madhe e tyre janë në kundërshtim me Kushtetutën e

Kosovës.

Në Serbi insistojnë në kompetenca të gjera për Asociacionin, ndërsa në Kosovë thonë se të tillat do ta rrezikonin funksionalitetin e shtetit. Së voni, bashkësia ndërkombëtare ka rritur trysinë mbi Kosovën, duke i kërkuar që të mos vonohet më me formimin e Asociacionit.

Por, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i ka kritikuar ndërmjetësuesit evropianë të bisedimeve për anshmëri dhe ka thënë se Kosova nuk do të pranojë kushte për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë pa u zyrtarizuar njohja de facto e Kosovës nga Serbia.

## Propozim i zgjuar

Edward P. Joseph, ligjërues në Universitetin "Johns Hopkins" në Uashington, ka thënë për "REL"-in se propozimi i presidentes Osmani që ShBA-ja ta udhëheqë dialogun është "mjaft i zgjuar". Sipas tij, Kosova po e shfrytëzon levën që i ka dhënë "sulmi katastrofik" në Banjškë, ku grupe të armatosura serbësh kanë sulmuar Policinë e Kosovës më 24 shtator, duke vrarë një polic. "Ky është me të vërtetë momenti që Prishtina ta tërheqë vëmendjen për atë që e sheh si çekuilibër në Bruksel. Sipas mendimit tim, çekuilibri i vërtetë nuk është te menaxhimi i dialogut nga BE-ja, është te fakti që dialogu udhëhiqet nga ish-ministrat e Jashtëm të dy vendeve që nuk e njohin Kosovën. Kjo ka krijuar një çekuilibër që në fillim. Si mund ta çoni Beogradin drejt ndonjë njohjeje të Kosovës - madje edhe njohje de-facto kur vendi juaj i originës refuzon ta njohë Kosovën?", ka thënë Joseph.

Ai u është referuar dy diplomatëve evropianë, Josep Borrell dhe Mirosllav Lajçak, të cilët vijnë nga Spanja, përkatësisht nga Sllovakia, të dyja vende të BE-së që nuk e njohin pavarësinë e Kosovës të

shpallur në vitin 2008.

Joseph ka thënë se propozimi që Kosova t'ia paraqesë ShBA-së konceptin e saj për Asociacionin, e forcon pozitën e Prishtinës, ndërsa e ekspozon Beogradin si kundërshtar të vërtetë të dialogut. Leon Hartwell, bashkëpunëtor i lartë në Shkollën e Londrës për Ekonomi dhe Shkenca Politike, ka thënë se nuk parashikon ndonjë ndryshim të madh në qasjen e ShBA-së ndaj dialogut Kosovë - Serbi.

ShBA-ja, sipas tij, ka qenë në përputhje me qëndrimin e Bashkimit Evropian për këtë çështje. "Ky harmonizim ka qenë veçanërisht i dukshëm në muajt e fundit. ShBA-ja i është bashkuar BE-së në presionin mbi Kosovën për ta themeluar Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. Për më tepër, vlen të theksohet se partneriteti BE-ShBA e ka fajësuar Kosovën gjithnjë e më shumë për dështimin e perceptuar të dialogut, edhe kur është e qartë se Serbia mban përgjegjësi për përshkallëzimin e konflikteve", ka thënë Hartwell për "Radion Evropa e Lirë".

Sipas tij, është e rëndësishme që ShBA-ja dhe BE-ja të pranojnë se dialogu aktual është në një ngërç, kryesisht për shkak të mungesës së angazhimit të Serbisë. "Vetëm kur të njihet ky realitet ne mund të fillojmë të hulumtojmë rrugë alternative për adresimin e çështjeve thelbësore të konfliktit Kosovë - Serbi", ka thënë Hartwell.

## Qëndrimi i ShBA-së për Asociacionin

Për ShBA-në, themelimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe duhet të jetë ndër hapat e parë që duhet t'i bëjë Kosova për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë.



Në një intervistë dhënë "Radios Evropa e Lirë" më 20 shtator, ambasadori amerikan në Prishtinë, Jeffrey Hovenier, ka thënë se Kosova duhet ta çojë përpara këtë marrëveshje. Sipas tij, ShBA-ja beson se Asociacioni duhet të jetë plotësisht në përputhje me Kushtetutën e Kosovës. "Ne nuk besojmë se duhet të ketë autoritete apo kompetenca ekzekutive. Serbia mund të kërkojë më shumë, por, në fund të fundit, kjo është ajo që Shtetet e Bashkuara dhe bashkësia ndërkombëtare janë të përgatitura ta shohin si të pranueshme", ka thënë ai.

## Qëndrimi i BE-së për Asociacionin

Për Bashkimin Evropian (BE), çështja se si bëhet Asociacioni, si do të duket dhe si do të operojë, duhet të diskutohet në dialog.

"BE-ja dhe vendet anëtare kërkojnë që themelimi i Asociacionit të nisë pa vonesa shtesë dhe pa parakushte", ka thënë zëdhënësi i BE-së, Petr Stano, më 21 shtator.

Kështu, ai nuk u është përgjigjur në mënyrë të drejtpërdrejtë pyetjeve të gazetarëve nëse statuti i Asociacionit duhet të jetë në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, e cila ka thënë se parimet e Asociacionit mund të harmonizohen përmes akteve ligjore.

Në fillim të majit në Bruksel është paraqitur një draft-statut i Asociacionit, i hartuar nga një ekip menaxhues që përbëhej prej katër pjesëtarësh të komunitetit serb, përfshirë një deputet të Kuvendit të Serbisë. Por, ai është refuzuar nga kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i

cili ka thënë se nuk është në pajtim "me kushtetutshmërinë, ligjshmërinë, të drejtat e njeriut, vlerat evropiane dhe të drejtat e pakicave sipas standardeve evropiane". Qeveria e tij ka dalë me të ashtuquajturin "model kroat" për Asociacionin, por ai nuk ka shkuar përpara.

## Ku qëndron dialogu?

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, kanë zhvilluar një raund të ri bisedimesh në Bruksel më 14 shtator, por pa ndonjë sukses. Ata nuk janë pajtuar rreth hapave për zbatimin e Marrëveshjes bazë për normalizimin e marrëdhënieve që është arritur në muajin shkurt dhe që përfshin edhe një detyrim për themelimin e Asociacionit. Ndërmjetësuesit evropianë të bisedimeve, diplomatët Josep Borrell dhe Mirosllav Lajçak, kanë thënë se ka qenë Kurti ai që nuk e ka pranuar propozimin e tyre për "përmbushje të njëkohshme" të detyrimeve që dalin nga kjo marrëveshje.

Kurti ka thënë se "kushtëzimi i Serbisë" për formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe "është shndërruar në qëndrim të emisarëve të BE-së". Ai e ka fajësuar Lajçakun për pozicionin kundër Kosovës dhe ka thënë se Marrëveshja bazë nuk mund të zbatohet me kushtëzime. Sipas Vuçiqit, "është e qartë se Kurti i shmanget formimit të Asociacionit". Departamenti amerikan i Shtetit është shprehur i zhgënjyer për mungesën e përparimit në këtë raund bisedimesh.


## Gërvalla kundër propozimit të Osmanit: Asociacioni ka vdekur

**PRISHTINË, 29 SHTATOR** - Ministrja e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla, ka thënë se Asociacioni Komunave me Shumicë Serbe ka vdekur. Kjo deklaratë e Gërvallës është në kundërshtim të plotë me propozimin e presidentes Vjosa Osmani, e cila ka deklaruar se Kosova duhet ta hartojë draftin e Asociacionit së bashku me ShBA-në. Ajo në një intervistë në "Top

Channel" ka thënë se tashmë ka prioritet krejtësisht të ndryshme në lidhje me Bashkimin Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pas sulmit terrorist të së dielës, në fshatin Banjškë të Zveçanit, ku është vrarë polici Afrim Bunjaku. Sipas Gërvallës, siguria është prioriteti kryesor i diskutimeve me ndërkombëtarët, gjë e cila e ka ndryshuar pozitën e Kosovës

pas 24 shtatorit. Kryediplomatja Gërvalla ka thënë se nuk ka shkelje më të rëndë sesa agresioni i hapur ndaj atij që pretendon që ke në tavolinë. "Të them të drejtën pas të dielës çdo bisedë për Asociacionin më duket e tepërt se pas të dielës nuk kanë kuptim. Asociacioni ka vdekur për ne dhe ndërkombëtarët. Ta koordinojmë punën e komunave në veri të Kosovës

është dallim tjetër. Janë katër parime: të mos shkelë sovranitetin, Kushtetutën, të mos dëmtojë dhe të jetë koordinues. Asociacioni i 2013-s është kundër Kushtetutës së Kosovës dhe nuk mund të bëhet. Escobari shumë qartë e ka përcaktuar se nuk mund të ketë Asociacion pasi mund të jetë një republikë e dytë serbe. Për ne ka qenë shumë e rëndësishme që shkelja e



Kushtetutës të mos jetë pjesë e marrëveshjes që kemi pranuar në Bruksel", ka thënë ajo.

## Ndërron jetë senatorja amerikane që kishte votuar për bombardimin e Serbisë

WASHINGTON, 29 SHTATOR - Ka ndërruar jetë në moshën 90-vjeçare Dianne Feinstein, senatore demokrate nga Kalifornia, e cila kishte shërbyer për më shumë se tri dekada dhe ishte një pioniere për gratë në politikën amerikane. Ajo kishte votuar për bombardimin e Serbisë në

vitin 1999. Feinstein ishte anëtarja më e vjetër e Senatit të ShBA-së dhe ka votuar deri të enjten. Për muaj të tërë demokratja nga Kalifornia kishte probleme shëndetësore. Ish-kryetarja e San Franciskos kishte njoftuar më parë planet për t'u tërhequr në fund të vitit të ardhshëm, por u rezistoi

thirrjeve që ajo të jepte dorëheqje.

Feinstein ishte e njohur si një avokate e zëshme për masat e kontrollit të armëve dhe një mbështetëse e madhe e ndalimit të armëve të nënshkruar në ligj nga presidenti Bill Clinton më 1994.



## Policia arreston disa persona falë bashkëpunimit policor ndërkombëtar

PRISHTINË, 29 SHTATOR - Policia e Kosovës ka njoftuar se falë bashkëpunimit ndërkombëtar ka realizuar me sukses disa ekstradime, transferime dhe depërtime të personave të ndryshëm që kanë rënë ndesh me ligjin. "Policia e Kosovës, përkatesisht Drejtoria për Bashkëpunim Ndërkombëtar Policor (ILECU), në kuadër të angazhimeve dhe detyrave ligjore të bashkëpunimit ndërkombëtar me shtetet e tjera, gjatë periudhës së fundit, e mbështetur edhe nga njësitet e tjera policore, ka realizuar me sukses disa ekstradime, transferime dhe depërtime të personave të ndryshëm që kanë rënë ndash me ligjin", ka njoftuar policia.

Sipas policisë, më 13 shtator është ekstraduar nga Shqipëria personi me inicialet A. K., qytetar i Republikës së Kosovës (RKS), i cili

ka qenë i kërkuar me urdhërarrest ndërkombëtar nga autoritetet për veprën penale "Mashtrim". Me datë 15.09.2023 është ekstraduar nga Gjermania personi me inicialet L. T., qytetar i RKS, i kërkuar me urdhër arrest ndërkombëtar nga autoritetet tona për veprën penale "Vrasje". Më datë 18.09.2023 është realizuar një depërtim i një shtetasi spanjoll, i cili ka qëndruar në RKS pa asnjë dokument. Ky depërtim është realizuar me ndërmjetësimin e Shqipërisë. Me datë 19.09.2023 është kryer transferimi i personit të dënuar nga Italia në Kosovë. Personi i transferuar me inicialet H. I., qytetar i RKS-së, i dënuar me 22 vjet burgim nga Italia për veprën "Trafikim me narkotik", tani do të kalojë pjesën e mbetur të vuajtjes së dënimit në burgjet e Kosovës. Me datë 22.09.2023, pas



koordinimit dhe shkëmbimit të informacioneve reciproke, autoritetet e Malit të Zi e kanë arrestuar në Podgoricë personin e kërkuar me urdhër arrest ndërkombëtar me inicialet M. K., qytetar i RKS i nacionalitetit serb, i

kërkuar nga autoritetet tona për veprën penale "Krime lufte". Personi i arrestuar është në proces të ekstradimit nga Mali i Zi në Kosovë sipas procedurave ligjore. Me datë 26.09.2023 është ekstraduar nga Mali i Zi personi

me inicialet Sh. P., qytetar i RKS-së, i kërkuar me urdhër arrest ndërkombëtar nga autoritetet tona për veprën penale "Vjedhje e rendë". Me datë 28.09.2023 është ekstraduar nga Gjermania personi me inicialet A. B., qytetar i RKS-së, i kërkuar me urdhër arrest ndërkombëtar nga autoritetet tona për veprën penale "Shpërdorim i detyrës zyrtare", ka njoftuar Policia e Kosovës.

Policia e Kosovës përmes Drejtorisë për Bashkëpunim Ndërkombëtar Policor (ILECU) ka vazhduar avancimin e bashkëpunimit ndërkombëtar me institucionet e zbatimit të ligjit të shteteve të tjera dhe me organizatat ndërkombëtare policore dhe të sigurisë me qëllim arrestimin e personave të kërkuar me urdhër arrest ndërkombëtar, ekstradimin apo sjelljen e tyre para organeve të drejtësisë.

## Protestojnë punëtorët e Kardiologjisë, kërkojnë shkarkimin e menaxhmentit

PRISHTINË, 29 SHTATOR - Punëtorët shëndetësorë të Klinikës së Kardiologjisë në QKUK kanë protestuar të premten për të shprehur pakënaqësi në lidhje me menaxhmentin e kësaj klinike, duke kërkuar shkarkimin e drejtorit Lulzim Kamberi dhe shefit të Njesisë Koronare, Artan Ahmeti.

Aurora Bakalli, kardiologe, ka thënë se peticioni i tyre prej 18 kardiologëve nënshkruar nuk është marrë parasysh, prandaj edhe janë detyruar të dalin në protestë. "Pas peticionit të 18 kardiologëve të QKUK-së të datës 11 korrik dhe takimit me drejtorin e Klinikës të ndërmjetësuar nga drejtori i përgjithshëm i ShSKUK-



së me datë 4 gusht, asnjë nga kërkesat tona nuk janë përfillur, madje ka pasur presion të

vazhdueshëm ndaj nënshkruarve të caktuar të peticionit. Duke mos parë rrugë tjetër për t'i zgjidhur

pakënaqësitë në Klinikën e Kardiologjisë, jemi të shtyrë që të fillojmë me hapa sindikalë, në këtë rast me protestë njëorëshë", ka thënë Bakalli, duke i renditur kërkesat e kardiologëve. "Kërkesat tona janë si në vijim: Të shkarkohet drejtori i klinikës, dr. Lulzim Kamberi, për shkak të përkrahjes së pazërvë të shkaktarit të dhunës në Klinikë, paafhtësisë menaxheriale, diskriminimit në baza gjinore, profesionale dhe edukative ndaj punëtorëve të caktuar, nxitjes së konflikteve ndërkolegiale, rolit tejet përçarës në kolektiv, kurdijes së konkursit për shefa të njësive, ikjes nga përgjegjësia profesionale, mungesës së transparencës,

paafhtësisë për pajisje me aparaturë të domosdoshme dhe furnizim me material bazik të Klinikës. Të shkarkohet shefi i Njesisë Koronare, dr. Artan Ahmeti, i cili para se ta merrte vendimin për këtë pozitë, ka shkaktuar dhunë fizike ndaj kolegut", ka thënë Bakalli.

Protestuesit para objektit të Klinikës së Kardiokirurgjisë kanë vendosur disa pankarta ku shkruanin: "Stop diskriminimit profesional, edukativ e gjinor", "Të shkarkohet menaxhmentit që mbrohet dhunuesit", "Stop diskriminimit të pacientëve nga lista e pritjes", "Stop dhunës fizike dhe dhunës psikike" dhe "Stop keqmenaxhimit të Klinikës".

## Nënshkruhet protokoli për ndërtimin e rrugëve të reja që ndërlidhin fshatrat në kufirin Kosovë - Shqipëri

PRISHTINË, 29 SHTATOR - Ministri i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu, ka njoftuar se nga tani e tutje do t'i ndërlidhin me rrugë të reja e të asfaltuara të gjitha fshatrat e brezit kufitar Kosovë - Shqipëri. Me këtë rast, Aliu ka bërë me dije se të premten kanë nënshkruar protokollin për zbatimin e marrëveshjes për

ndërtimin e rrugëve të fshatrave ndërkufitare që ndërlidhin fshatrat ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë. "Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje, përveçse do të ndërlidhemi më afër me njëri-tjetrin ekonomikisht, bashkërisht do të kontribuojmë në vlerësimin e gjendjes dhe përmirësimin e rrugëve të fshatrave ndërkufitare që lidhin zonat

kufitare Shqipëri - Kosovë. Zona e përbashkët në mes të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës, e cila do të mbulohet me këtë program zhvillimi, është e përbërë nga Bashkia e Hasit dhe Kukësit në Republikën e Shqipërisë, si dhe komuna e Prizrenit dhe Dragashit në Republikën e Kosovës", ka njoftuar Aliu.



# Aleksandër Vuçiqi, komandant i paaftë, frikacak dhe kriminel

Shkruan: Prof. dr. Kudusi Lama, gjeneral në pension

Një luftë e vogël ndodhi. Një provë e fshehtë agresioni u bë. Një fitore e shqiptarëve u evidencua në histori. Një humbje dhe turpërim i Serbisë ndodhi. Dhe pse? Vetëm se një president shteti, i quajtur Aleksandër Vuçiq, që e ka marrë Serbinë peng për interesat e filozofisë së tij politike si trashëgimtare e filozofisë fashiste të Milosheviçit, ka dëshirë të mbetet në historinë e kombit të tij si i madh.

Po a mund të jetë i madh një komandant që vret dhe pret në besë ushtarët e tij? A mund të ketë jetë i madh një njeri që dërgon ushtarët e tij për të bërë akte terroriste në shtetet fqinje? A mund të jetë i madh një komandant që pasi dështojnë i mohon ushtarët e tij?

Gjithë bota i pa komandot terroriste serbe, por ato nuk i ka parë komandanti i përgjithshëm i tyre Aleksandër Vuçiq.

Pikërisht ai që i organizoi, ai që i përgatiti e i trajnoi, ai që i pajisi me pajisjet, armët dhe municionet më moderne të kohës, ai që u bëri edhe planin e operacionit, ai që ishte në pritje edhe të rezultateve të operacionit, kur komandoja terroriste dështoi me turp, ai, komandanti i përgjithshëm dhe presidenti i Serbisë Aleksandër Vuçiq, i mohoi ato, i degradoi, i quajti qytetarë të fshatit që kishin dalë të mbroheshin prej Albin Kurtit, duke ua rrëzuar personalitetin ushtarëve të tij më besnikë.

Ata ushtarë, vërtetë bënë një vepër të rëndë terroriste, ata u futën dhe bënë agresion në një shtet fqinj, ata u treguan nivel i ultë duke vrarë zyrtarin e policisë së Kosovës Afrim Bunjakun, i cili ishte duke bërë një vepër humane, duke liru rrugën që e kishin zënë, me qëllim, të qarkullojnë lirshëm qytetarët, pavarësisht nacionalitetit të tyre, shqiptarë, serb, boshnjakë, turq, romë etj. Ata bënë vepra të turpshme edhe duke u futur në një objekt kulti fetar, por në fund të fundit ata ishin duke zbatuar një urdhër. Ishin duke zbatuar detyrën që kishin marrë nga komandanti i përgjithshëm i Forcave të Armatosura të Serbisë Aleksandër Vuçiq.

Jam i sigurt, se edhe në efektivin e asaj komandoje jo të gjithë kanë ardhur në atë rajon të Kosovës me bindje për të bërë krime. Mund të jenë dy, ndoshta edhe pesë, ata që kanë ardhur me bindje për të bërë terrorizëm në Kosovë. Por të tjerët i kanë futur në rresht e u kanë thënë të shkojnë në detyrë.



Unë do të desha që ata burra serb që u vranë të ishin pranë familjeve të tyre. Unë do të desha që qytetarët serb të jetojnë të qetë në vatrat e tyre.

Por ja që kanë një komandant të pabesë, të pa aftë, frikacak dhe kriminel, i cili edhe kur nuk mund të arsyetojë atë që ndodhë, mbyll sytë e tij dhe e quan të pa ndodhur. E turpshme për të. Ai duhet t'u kërkojë falje serbëve që luan me ta.

Është e turpshme për Aleksandër Vuçiqin, që ushtarët e tij i quajti qytetarë të fshatit në Banjskë, që ishin revoltuar me kryeministrin e tyre Albin Kurtin, ky komandant i mbrapsht që siç duket edhe ëndrrat i shikon me Albin Kurtin. Nuk qe i zoti as të dilte publikisht të thoshte: Po, këta janë ushtarët e mi, i kam dërguar unë, se ashtu e mendova, ose më kanë rebeluar pa dijeninë time, por megjithatë janë ushtarët e mi. Por ai nuk e bëri, ai dezertoj nga detyra e komandantit duke u fshehur pas gishtit megjithëse gjithë bota e ka parë.

Unë nuk do t'i kisha mohuar kurrë ushtarët e mi, çfarëdo që të kishte ndodhur. Kurrë nuk do të isha fshehur nga ushtarët e mi, sepse do të më vinte turp prej tyre.

Kosova vërtetë humbi një kuadër të policisë së saj. Por fitoj një dëshmor, fitoj një hero të saj. Megjithëse do të donim ta kishim në radhët e repartit të tij dhe pranë familjes e fëmijëve të tij. Por ja që atdheut i nevojiten edhe dëshmorët kur ka djallin fqinj, që ka dëshirë në çdo kohë të djegë shtëpinë e tjetrit.

Megjithatë Policia e Kosovës, e bëri betejën e saj, e dha mesazhin e forcës dhe të profesionalizmit të saj, e dha mesazhin e shpirtit luftarak dhe atdhetar përballë armikut, duke e asgjësuar atë plotësisht, duke e bërë të marrë arratinë, për t'i qar komandantit të përgjithshëm mesazhin e disfatës së tij.

Unë sot ndihem mirë dhe i sigurt nën mbrojtjen e atyre djemve dhe burrave që na bënë krenar. Të cilët i treguan botës se ky vend ka zot dhe se sado të përpiqen fashistët, kockat do të lënë në trojet e këtij populli paqedashës.

Dhe të dish mirë o komandanti i përgjithshëm i Serbisë se mbetjet e grupit terrorist që organizove, përgatite dhe dërgove në Kosovë erdhën te familjet e tyre sepse shqiptarët nuk janë vrasës. Burrat shqiptarë të policisë së Kosovës ua lanë një shteg hapur mbetjeve të

terroristëve të tu që të largohen, sepse nuk deshën t'i vrasin më tej. Prandaj ji mirënjohës ti dhe të gjithë ata që u kthyen në familjet e tyre.

Tani po të ka mbetur pak qytetari evropiane, arrestoi dhe dërgoi në Kosovë ku kanë kryer krimin të dënohen sipas ligjeve të shtetit, të cilët i kanë cenuar sovranitetin dhe i kanë vrarë një punonjës sigurie në detyrë pa asnjë arsye.

Uroj që të mos kemi më veprime të tilla. Por uroj që edhe ushtarakët, policët dhe komandot serbe, të kenë kuptuar se komandanti i tyre i përgjithshëm Aleksandër Vuçiq, nuk është prej atyre burrave që edhe u vë detyrë e edhe i vlerëson për detyrën e kryer e për sakrificën e bërë. Uroj ta kenë kuptuar se ai edhe i dërgon të vriten edhe thotë nuk janë me mua e nuk di gjë për ta.

Kështu të paktën vepro komandanti Vuçiq në rastin e kësaj komandoje terroriste që u neutralizuar në Kosovë më 24 shtator 2023, që për çudi e kreu sulmin ditën e diel. E që përfundoj duke u mohuar. Unë kurrë nuk do të kisha nderim për atë lloj komandanti që më organizon, më trajnon, më pajis e më dërgon të kryej një detyrë, dhe pasi dështoj,

thotë nuk e njoh kush është, nuk ka lidhje me mua dhe nuk është shtetas i imi. Siç veproj Aleksandër Vuçiqi në rastin në fjalë.

Unë personalisht i bëra thirrje Aleksandër Vuçiqit që të distancohet si burrë prej kësaj komandoje. Dhe e kam pritur distancimin e tij, qoftë edhe për hatër të qytetarëve të Serbisë, për të bërë të mundur që të mos shihen në botë si terroristë. Por ai veproj siç nuk do të duhej të vepronte. Ai mohoi ushtarët e tij, duke i kthyer në qytetarë të revoltuar, për çka nuk e besoj askush dhe të gjithë vunë buzën në gaz me qëndrimin e tij, dikush me tallje, dikush për mëshirë, dikush për indiferentizëm e unë për neverinë që ndjej ndaj tij, duke vlerësuar se duhet të mos ishte kaq frikacak e kriminel, por të paraqitej burrë shteti e të mbante përgjegjësi para kombit të tij dhe para botës.

Kujtoj përgjigjen e Çurçillit, kur i bënë pyetjen pse u hutua Stalini më 22 qershor 1941, (që ndodhi ditën e diel, sepse siç duket fashistët këtë ditë e kanë si ditë fati), kur e sulmoi Gjermania Bashkimit Sovjetik dhe nuk besonte se Hitleri mund të kishte dhënë një urdhër të tillë. Çurçilli u përgjigj: Stalini ishte burrë shteti dhe mendonte se edhe Hitleri do të ishte si ai, prandaj nuk kishte si ta dinte se përballë kishte një bakabond. E kujtova këtë se sido që të ishte Aleksandër Vuçiq nuk kam menduar kurrë se ai mund të jetë realisht një komandant i pa aftë, frikacak dhe kriminel që plotëson portretin e një bakabondi, kam menduar se duhet të jetë burrë shteti, megjithëse armik, por jo, nuk qenka i tillë. Komandoja terroriste që me urdhër të tij bëri agresion në Kosovë, është treguesi më i plotë i këtij përfundimi.

Prandaj do ta këshilloja këtë komandant të dobët, që vret dhe mohon ushtarët e tij, që të mos guxojë më, sepse ajo që ndodhi është një tregues i gjallërisë së shpirtit kombëtar shqiptar. Me veprime të tilla, shqiptarëve veç u freskon kujtesën e ushtarët tu i merr në qafë, ua shkurton jetën për interesat tua. Leni serbët të bëjnë jetën e tyre. As ata nuk ta kanë ngenë të shkojnë sipas oreksit tënd. Dhe duhet të dish se një ditë do të dënojnë me turp. Vula e lirisë së Kosovës është e patjetërsueshme. Ajo mbështetet në simbolin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Mbështetet në të drejtën për liri të kësaj toke që ka histori të lavdishme e të thellë në kohë, përtej çdo lashtësie.

## Kurti: Pas sulmit terrorist në veri ndoshta qëndron Moska

Prishtinë, 29 shtator - Moska ndoshta fshihet pas sulmit terrorist në veri të Kosovës, ka thënë kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në një intervistë me Avda Avdiq për "Istraga.ba". "Moska ndoshta

qëndron pas sulmit terrorist në veri të Kosovës", ka thënë Kurti.

Kryeministri i Kosovës ka folur edhe për propozimin e kryeministrit shqiptar, Edi Rama, që KFOR-i ta marrë

kontrollin e veriut të Kosovës. "Ne kemi nevojë për patrulla të përbashkëta të policisë sonë dhe KFOR-it përgjatë kufirit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. E për sa iu përket gjërave të tjera, kjo

tashmë është vendosur. Kudo në Kosovë – e para që përgjigjet është policia jonë, pastaj EULEX-i dhe më pas KFOR-i. Dhe nuk mendoj se kjo formulë duhet ndryshuar", ka thënë Kurti.



## Shahini takohet me kryetarin e Odës Afrikë-Balkan, pajtohen për bashkëpunim ekonomik

PRISHTINË, 29 SHTATOR - Kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve (AKB), Agim Shahini, është takuar me një delegacion nga Kameruni, i kryesuar nga kryetari i Odës Afrikë-Balkan, Assako Ella Emmanuel Delphin. Me këtë rast, Shahini ka thënë se Kosova dhe Shqipëria po nisin një udhëtim emocionues drejt bashkëpunimit ekonomik dhe

kulturor me Kamerunin. "Takimi ynë është fillimi i një rrugëtimi të ri, ku do t'i ndajmë vlerat ekonomike, diplomatike dhe kulturore, me qëllim të ndërtimit të lidhjeve të forta dhe projekteve të suksesshme. Bashkëpunimi ynë do t'i kultivojë marrëdhëniet në mes të komuniteteve tona dhe do t'i hapë dyert për mundësi të reja biznesore", ka thënë Shahini.

Ndërsa kryetari i Odës Afrikë-Balkan, Assako Ella Emmanuel Delphin, ka thënë se ka gatishmëri për ta promovuar bashkëpunimin ekonomik, diplomatik, politik dhe kulturor. Sipas tij, ky bashkëpunim është frymëzues i vërtetë dhe udhëheqës që do të sjellë ndryshime pozitive në mes të vendeve dhe bizneseve të Ballkanit dhe Afrikës.



## Kriza ekonomike në Kosovë, pasojat e rritjes së pakontrolluar të çmimeve

PRISHTINË, 29 SHTATOR - Si shumë vende të tjera edhe Kosova gjatë këtij viti është duke u ballafaquar me rritje të theksuar të çmimeve. Rënia e ofertës në tregjet ndërkombëtare, mungesa e kapaciteteve prodhuese të brendshme dhe rritja e ndjeshme e kërkesës janë ndër shkaktarët kryesorë për këtë situatë. Rritja e vazhdueshme dhe e pakontrolluar e çmimeve të artikujve bazë në Kosovë është duke e rënduar gjithnjë e më shumë gjendjen ekonomike të shumë familjeve. Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka bërë me dije se indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 3.2-përqindësh në muajin gusht 2023 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022.

Sipas raportit të ASK-së, ngritja e çmimit të konsumit ka ndodhur te perimet për 28 për qind, pemët për 11.4 për qind, mobiliet, pajisjet shtëpiake dhe mirëmbajtja e shtëpisë për 7.2 për qind. Po sipas këtij raporti, pijet alkoolike dhe duhani janë

shtrenjtuar për 6.3 për qind, pijet joalkoolike për 5.7 për qind, blerja e automjeteve për 5.1 për qind, buka dhe drithërat për 4.5 për qind, energjia elektrike, gazi dhe lëndet djegëse të tjera për 4.5 për qind, shërbimet për transport për 4.4 për qind, mishi për 3.8 për qind dhe qumështi, djathi dhe vezët për 2.4 për qind, me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 3.4-përqindësh në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK-it). Ndërsa sipas ASK-së, rënie e çmimeve është vërejtur te grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: vajrat dhe yndyrat për 14.5 për qind dhe lëndët djegëse të ngurta, dru zjarri, pelet etj. për 3.7 për qind dhe me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 0.2-përqindësh në IHÇK. Kurse indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 1-përqindësh në muajin gusht 2023.

Me këtë rast, ekonomisti Egzon Kastrati ka thënë se Qeveria e Kosovës ka vepruar në raport me inflacionin përmes masës




monetare apo rritjes së pagave me ligjin e ri. Ai ka theksuar se tendenca për mungesë të kontrollit të çmimeve ka sjellë "pasojat e disfunkcionit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës". "Në rast se masat

ndëshkuese do të kishin qenë të efektshme, ato do të ndikonin në frenimin e kësaj tendence të rritjes së çmimeve", ka thënë ai për "Dukagjinin". Megjithatë, sipas tij, "zvogëlimi i produkteve në treg është duke favorizuar formimin e

karleve dhe marrëveshjeve të fshehta midis tregtarëve që në mënyrë të përsëritur dëmtojnë konsumatorët, duke i lënë ata të prekur edhe në sasi të ndryshme". Ndërsa ekonomisti Naim Huruglica ka thënë se ky veprim i kompanive për zvogëlimin e sasisë dhe mbetjes konstante të çmimit nënkupton inflacion.

Ditë më parë për trendin rënës të ekonomisë ka reaguar deputeti nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, duke thënë se rënia ekonomike po vazhdon gjatë gjithë mandatit të kësaj qeverie. "Pa zot shtëpie që kujdeset për ekonominë e bashkëpunon me sektorin privat, rritja ekonomike është shafitur në nivele të ulëta që as amortizimi i kapitalit nuk mbulohet. Kjo ka qenë e pritshme. Në tri vite të qeverisjes, nuk ka asnjë politikë ekonomike e fiskale që siguron punësim e prodhim të qëndrueshëm. Investimet publike në tri vitet e fundit janë tkurrur jashtëzakonisht shumë. E gjithë politika ekonomike është reduktuar në subvencione, të cilat mundësojnë mbijetesë, por jo zhvillim", ka thënë Hoti.

## Krahasuar me vitin e kaluar, rritet numri i vizitorëve në hotele gjatë gushtit 2023



PRISHTINË, 29 SHTATOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka njoftuar se gjatë muajit gusht ka pasur rritje të numrit të vizitorëve në hotelet e Kosovës krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Sipas ASK-së, në gusht këtij viti numri i vizitorëve (vendorë dhe të huaj) ishte 71 232, prej tyre 35.83 për qind kanë qenë vendorë dhe 64.17 për qind

të huaj. Krahasuar me muajin gusht të vitit 2022 (sa ishin 60 952 vizitorë) në muajin gusht të këtij viti kishte rritje të numrit të përgjithshëm të vizitorëve për 16.7 për qind. ASK-ja ka treguar se numri i net-qëndrimeve ka qenë 166 377, prej tyre 44.05 për qind nga vendorët dhe 55.95 për qind nga të huajt. Numrin më të madh të vizitorëve

të brendshëm e ka pasur rajoni i Pejës me 8 036 vizitorë dhe 35 149 net-qëndrime. Sa iu përket vizitorëve të huaj, krahasuar me periudhën paraprake (gusht 2022), ka pasur rritje të vizitorëve për 6.37 për qind. Në total ka pasur 45 711 vizitorë të huaj, nga të cilët numri më i madh është nga Gjermania, Shqipëria, Zvicra etj.

## Kuvendi i Gjilanit dështon ta miratojë buxhetin për vitin 2024

GJILAN, 29 SHTATOR - Kuvendi Komunal i Gjilanit ka dështuar ta miratojë propozim-buxhetin për vitin fiskal 2024, bashkë me vlerësimet e hershme për vitet 2025-2026, të cilin e ka paraqitur Ilmi Limoni, përgjegjës për financa në këtë komunë. Në favor të propozim-buxhetit kanë

qenë 12 asamblistë dhe 16 kundër. Opozita në Gjilan, LDK-ja dhe PDK-ja, të cilat e kanë shumicën në Kuvend, janë deklaruar kundër propozim-buxhetit, me arsyetim se është i planifikuar keq dhe si i tillë është i perealizueshëm. Pas këtij dështimi, Kuvendi Komunal është detyruar t'i

ndërpresë punimet për shkak të mungesës së kuorumit, pasi asamblistët e Vetëvendosjes dhe partnerët e saj qeverisës e kanë braktisur seancën. Kryetari i Gjilanit, Alban Hyseni, ka thënë se arsyet e opozitës për të mos e votuar propozim-buxhetin janë të paqëndrueshme.





# Historia e Shqipërisë, Bernd Fischer: Nuk mund të kuptohet, pa njohur popullin



Bernd Fischer, një nga studiuesit më të njohur të historisë, zhvilloi në Tiranë një bashkëbisedim për librin e tij “Një histori e përmbledhur e Shqipërisë”. Ai komentoi dhe zhvillimet në Kosovë duke u shprehur se duhet të ketë më shumë presion ndaj Serbisë për të njohur pavarësinë.

Historiani dhe studiuesi i njohur gjerman i historisë shqiptare, Bernd J. Fischer zhvilloi një bashkëbisedim me kolegë, historianë shqiptarë, dhe lexues mbi librin “Një histori e përmbledhur e Shqipërisë”, botuar një vit më parë me bashkautor studiuesin Oliver Jens Shmitt.

Libri, botimi i të cilit u kërkua nga Universitetit të Kembrixhit është historia e shtetit shqiptar, e

ndarë në dy pjesë për të paraqitur historinë komplekse të Shqipërisë. Autori thotë se historia e shtetit shqiptar, nuk mund të tregohet pa kuptuar më parë historinë e popullit shqiptar.

“Pjesa e parë flet ndërlidhjet e tyre me romakët, bizantinët, otomanët, venecianët dhe fuqitë e mëdha moderne dhe gjithashtu në marrëdhëniet e tyre me kombet e tjera ballkanike sllave, greke dhe rumune duke përfshirë çështjet komplekse të gjuhës dhe fesë.

Pjesa e dytë e librit është historia e shtetit shqiptar, natyrisht që fillon me pavarësinë dhe më pas përfshin tmerret e luftës së parë botërore, periudhën kritike të mesluftës nën sundimin e mbretit zog, luftën e dytë

botërore, regjimin e Enver Hoxhës dhe rimëkëmbjen postkomuniste”, -tha Bernd J. Fischer.

Autorët kanë ndarë në mënyrë objektive interpretimet nacionaliste dhe me anë të fakteve rrezojnë teza abuzive që hedhin idenë e një shteti të sajuar.

Pjesë e bashkëbisedimit ishte gjithashtu Drejtori i Bibliotekës Kombëtare Pirro Misha i cili e komenton librin si një vlerë e shtuar e studimeve shqiptare.

“Është një libër që i jep shumë studimeve shqiptare dhe mendoj se është një kontribut shumë i rëndësishëm në historiografinë shqiptare. Sigurisht që do të hapë polemika dhe debate, por ky është qëllimi i një libri. Unë mendoj se është

një libër që nxit mendime, sepse sfidon disa nga rrëfimet tradicionale të të ashtuquajturës historiografi zyrtare. Është një libër ku shumë faqe të historisë sonë janë paraqitur ndryshe nga tekstet shkollorë”, -tha Pirro Misha.



Për situatën aktuale në Kosovë, historiani, Bernd J. Fischer theksoi se ndihet i keqardhur se duhet më shumë presion ndaj Serbisë për të rregulluar marrëdhëniet e tyre me Kosovën.

“Unë isha në Kosovë dhe bisedova me njerëzit në Prishtinë, dhe ka shumë pikëpamje të ndryshme se kush është përgjegjës, dua të them se kush qëndron pas ngjarjes. Mendoj se është një përshkallëzim serioz i

marrëdhënieve mes Serbisë dhe Kosovës. Unë sigurisht shpresoj që rezultati të jete ndoshta pak më shumë presion për Serbinë për të rregulluar marrëdhëniet e tyre me Kosovën dhe më pas përfundimisht për ta njohur Kosovën si një shtet të pavarur.

Nuk jam i sigurt se ky do të jetë rezultati, por ne me siguri shpresojmë dhe padyshim, si gjithë të tjerët, më vjen keq për humbjet e jetës dhe shpresoj që kjo të mos ndodhë më”, -tha Bernd J. Fischer.

Përpjekja e dy autorëve, Bernd J. Fischer dhe Oliver Jens Shmitt për të zërthyer një sërë mitesh të rrëfimeve tradicionale, do të hapë debate dhe do të ketë reagime, por sigurisht që do të kontribuojë në mënyrën se si ne e shohim historinë tonë.



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

## Sot përballja e dy skuadrave kryesuese Ballkani - Llapi

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 29 SHTATOR - Pas ndeshjeve të mesjavës, Superliga e Kosovës në futboll do të vazhdojë këtë fundjavë me xhiron e tetë. E veçanta e kësaj xhироje është se do të zhvillohen dy ndeshje. Në Suharekë përballen dy skuadrat e para në renditjen tabelore, Ballkani dhe Llapi. Këto skuadra kanë pikë të barabarta (16), por kampionët e Ballkanit kanë një ndeshje më pak të zhvilluar. Sot (e shtunë) zhvillohet

edhe përballja tjetër mes Lirisë dhe Malishevës, e cila, po ashtu, do të jetë interesante për faktin se prizrenasit kërkojnë rezultat pozitiv, sikurse edhe Malisheva që në mesjavë është mposhtur në minutat e fundit nga Llapi. Të dielën në stadiumin "Sami Kelmendi" në Lipjan do të zhvillohet derbi i Anamoravës mes Dritës dhe Gjilanit. Drita është e treta në tabelë me 12 pikë, kurse Gjilani në pozitën e gjashtë me 7 pikë. Të dielën zhvillohet edhe ndeshja tjetër. Në Klinë Dukagjini e pret Feronikelin 74.

Ndeshja e fundit për këtë javë zhvillohet të hënën mes Fushë-Kosovës dhe Prishtinës.

### SUPERLIGA - JAVA 8

**Të shtunën takohen:**  
15:00 Ballkani - Llapi  
15:00 Liria - Malisheva

**Të dielën takohen:**  
15:00 Drita - Gjilani  
15:00 Dukagjini - Feronikeli 74

**Të hënën takohen:**  
15:00 Fushë-Kosova - Prishtina



## KOK-u organizoi konferencën 'Forumi për Sportin', në kuadër të Javës Evropiane të Sportit

PRISHTINË, 29 SHTATOR - Komiteti Olimpik i Kosovës, në bashkëpunim me Ministrinë për Kulturë, Rini e Sport, ka organizuar të premten edicionin e pestë të konferencës "Forumi për Sportin", që është mbajtur në kuadër të Javës Evropiane të Sportit 2023. Presidenti i KOK-ut, duke bërë thirrje që të jemi sa më aktivë (BeActive), që është edhe motoja e javës, foli për mikpritjen e Lojërave Mesdhetare Prishtina 2030 si dhe për organizimin e forumit ndërkombëtar Platforma Evropiane e Sportit

2024, për të cilat tha se të gjithë bashkërisht synojmë të jemi shembull i organizimit dhe frymëzimit për të tjerët. Koordinatori nacional i Javës Evropiane të Sportit në Kosovë, Ibër Alaj, foli për aktivitetet e organizuara dhe për rëndësinë që ka marrja me aktivite fizike. Konferenca u zhvillua në formë të panelit, ku në panel, krahas Alajt, ishin edhe sekretari i përgjithshëm i KOK-ut, Besim Aliti, drejtori i sportit në komunën e Prishtinës, Granit Rugova, trajnerja e gjimnastikës Abelianna Bregu dhe gjyqtarja e



tenisit, Blearta Ukëhaxhaj, Kosovës për promovimin e njehërësh ambasadore e vlerave olimpike në garat e

EYOF-it. Panelistët folën për Lojërata Mesdhetare Prishtina 2030 si dhe të qenit aktivë me aktivitete fizike, derisa të pranishmit, që kryesisht ishin drejtues të federatave sportive, përfaqësues të MKRS-së, dekani i FEFS, Musa Selimi, patën mundësinë të diskutojnë për LM Prishtina 2030, duke kërkuar njëkohësisht sqarime të nevojshme në lidhje me mënyrën e organizimit dhe investimeve që do të bëhen nga Qeveria e Kosovës. Aktiviteti u përcoll edhe me video të Javës Evropiane të Sportit.

## Rivalet e vjetër ndaj mejdantin në 'Minatori'



Prishtinë, 29 shtator - Fundjava sjell superderbin në mes të Trepçës dhe Sigal Prishtinës që zhvillohet në kuadër të javës së dytë të Prince Caffè Superligës. Rivalët e vjetër të basketbollit të Kosovës do të përballen në një tjetër sfidë interesante. Të dyja skuadrat kërkojnë fitoren e dytë radhazi në elitë, pasi e nisën kampionatin me fitore, duke mundur Istogun, përkatësisht Proton Cable Prizrenin. Së fundi u takuan në gjysmëfinale të Superkupës, ku fituan mitrovicasit, ndërkohë që të dyja skuadrat kanë ambicie të mëdha

në këtë edicion. Java e dytë hapet me takimin në mes të Bashkimit dhe Vëllaznimit. Prizrenasit e kanë nisur kampionatin me fitore, duke mundur Golden Eagle Yllin në udhëtim, ndërsa kuqezinjtë pësuan nga Peja. Të dielën Proton Cable Prizreni ndeshet me Pejën që, po ashtu, skuadrat hyjnë për fitore. Prizrenasit vetëm pas vazhdimëve u mposhtën nga prishtinasit në javën e parë, kurse verdhezinjtë mposhtën kuqezinjtë e Gjakovës. Ndeshja e fundit e kësaj xhироje

zhvillohet mes Golden Eagle Yllit dhe Istogut. Therandasit në xhiron e parë pësuan nga Bashkimi dhe duan fitoren e parë, kurse për istogasit është paraqitja e parë në elitë dhe duan të lënë gjurmë.

### SUPERLIGA - Java e dytë

**Të shtunën takohen:**  
17:00 Bashkimi - Vëllaznimit  
19:00 Trepça - Sigal Prishtina

**Të dielën takohen:**  
17:00 Proton Cable Prizreni - Peja  
19:00 Golden Eagle Ylli - Istogu

## Muriqi, lojtari i javës në La Liga

MALLORCA, 29 SHTATOR - Sulmuesi i Mallorcas, Vedat Muriqi, ka qenë lojtari më i vlerësuar i javës së shtatë në La Liga, duke qenë kështu pjesë e formacionit më të mirë. Kjo xhиро solli edhe rezultate befasuese. Një nga to ishte barazimi 2-2 i Mallorcas me

Barcelonën. Më meritori në këtë barazim të vendësve ishte sulmuesi i Kosovës, Vedat Muriqi, i cili shënoi golin e parë dhe asistoi në të dytin për ekipin e tij. Kjo paraqitje e mirë e sulmuesit prizrenas nuk mbeti pa u vlerësuar, pasi u vlerësua me notën më të lartë

këtë xhиро. Sipas faqes së specializuar të statistikave "Sofascore", Muriqi u vlerësua me notë 8.6, ndërsa pas tij ishin Raphina dhe Ivan Villar me notën 8.5. Në formacionin më të mirë të javës së shtatë e gjeten veten edhe Nacho Fernandez (8.2), Loic Bade

(7.5) dhe Gaston Alvarez (7.5) në mbrojtje. Në mesfushë, përveç Raphinas dhe Suson, u vlerësuan edhe Aleix Garcia (8.1), Erik Lamela (8.2) dhe Samuel Lino (8.0), ndërsa në sulm së bashku me Muriqin e gjen veten edhe Samu Omorodion (8.2).




## Bonucci: Kisha ofertë nga Lazio, por vendosa të vij tek Union Berlin

BERLIN, 29 SHTATOR - Ish-mbrojtësi i Juventusit, Leonardo Bonucci, ka folur së fundmi për vendimin e tij për të kaluar tek Union Berlin, teksa zbuloi që kishte pasur ofertë edhe nga Lazio. Në një konferencë për shtyp, italianit theksoi se ndihet i lumtur për

zgjedhjen që ka bërë. "Kisha dy opsione për të zgjedhur mes Lazios dhe Union Berlinit. Në fund të gushtit zgjodha Union Berlin. Pashë dy ndeshjet e para të Bundesligas dhe jam shumë i lumtur që erdha këtu për atmosferën, tifozët dhe ekipin.

Më pas fola me trajnerin dhe vendosa ta pranoj ofertën e Unionit për të përjetuar atë që ndoshta do të jetë sezoni im i fundit. Kam luajtur për 20 vjet në Itali dhe mendoj se ky vendim është shumë i rëndësishëm sepse në fund të

karrierës sime dua të jem një trajner. Besoj se ky vendim ma hap mendjen për gjëra të ndryshme si stili i jetesës dhe metodat e stërvitjes, gjëra që janë krejtësisht të ndryshme në Gjermani në krahasim me Italinë", ka deklaruar Bonucci.



## Hyseni për çmimin 'Ylli i javës': Motiv për të shënuar edhe gola të tjerë

### "Epoka e re"

PODUJEVË, 29 SHTATOR - Futbollisti i KF Llapit, Muhamet Hyseni, e ka fituar çmimin "Ylli i javës" për javën e 7-të të Albi Mall Superligës. Komisioni i veteranëve të futbollit në përbërje: Muhamet Sylejmani, Selatin Jerliu, Fatmir Mehmeti, vendosi që epiteti i më të mirit për këtë xhiro t'i takojë sulmuesit të skuadrës llapjane, pasi në ndeshjen në udhëtim kundër FC Malisheva ishte lojtari më i dobishëm dhe efikas në fushë duke shënuar dy gola, duke i mundësuar kështu ekipit të tij që në minutat shtesë të fitojë tri pikë të rëndësishme për ta ruajtur kreun e tabelës në elitë. Çmimin "Ylli i javës" për futbollistin e KF Llapit, Muhamet Hysenit ia dha Andi Sadiku, dizajner grafik në Albi Mall. Pasi mori këtë çmim, Hyseni



u shpreh i lumtur për vlerësimin duke premtuar spektakël golash edhe në xhirot e ardhshme, për faktin që skuadra e tij po tregon karakter të lartë. "Jam jashtëzakonisht i lumtur që jam shpallur 'Ylli i javës'. Ky çmim më motivon edhe më shumë për të punuar dhe realizuar edhe gola të tjera. E kemi nisur shumë mirë

edicionin e ri dhe jemi në rrugën e duhur për t'i arritur objektivat tona. Kam besimin maksimal të shtabit teknik, bashkëlojtarëve dhe tifozëve, gjë që u falënderohem në maksimum. Tifozëve u premtoj edhe gola të tjera që së bashku të arrijmë suksese", ka thënë Hyseni për faqen zyrtare të FFK-së.

## Fury: Njerëzit do të tallen me mua nëse humbi ndaj Ngannou, ashtu sikurse kur Unitedi humbi nga Liverpooli 7-0

MANCHESTER, 29 SHTATOR - Boksieri britanik Tyson Fury po përgatitet për duelin e 28 tetorit ndaj ish-kampionit të botës në UFC, Francis Ngannou. Kjo sfidë do të zhvillohet në Arabi. Fury, kampion bote në peshën e rëndë, në një intervistë me Rio Ferdinand, u shpreh se humbja ndaj Ngannou do të ishte po aq turpëruese sa humbja 7-0 e Manchester Unitedit me Liverpoolin sezonin e kaluar. Kur u pyet se çfarë kërcënimi paraqet Ngannou, Fury u përgjigj: "Ai është i fortë fizikisht, një grushtues dinamik me të dyja duart. Ai është regjistruar në librin e rekordeve Guinness si grushtuesi më i vështirë. Ka goditur ndonjëherë ndonjë gjë, kështu që ekziston ai rrezik. Rreziku më i madh nga të gjithë është të luftosh me një luftëtar MMA dhe unë jam kampioni i botës në peshën e rëndë, kështu që çfarë ndodh nëse



ai me mund mua? Njerëzit do të tallen me mua. Do të ishte njësoj si atëherë kur Manchester Unitedi u mund 7-0 nga Liverpooli. Apo jo?", u shpreh Fury, i pamposhtur në karrierën e tij. "Djajtë e kuq" u poshtëruan nga rivalët e tyre kur luajtën më 5 mars në "Anfield". Kjo ishte humbja më e madhe e Manchester Unitedit në Premierë Ligë dhe humbja më e keqe qëkur Erik ten Hag u bë trajner më 2022. Fury është tifoz i Manchester

Unitedit. Ajo humbje mund të jetë e dhimbshme për të si tifoz, humbja ndaj Ngannou do ta dëmtonte shumë moralisht kampionin e pamposhtur të botës në peshën e rëndë. "Të gjithë këta kundërshtarë me të cilët përballëm, të gjitha janë luftime të rrezikshme ose janë të gjithë burra të mëdhenj. Të gjithë këta djem janë gunga të mëdha dhe kur i luftoj rreziku është gjithmonë i njëjtë. Ata kanë një shans për goditje me grusht. Por nuk lë kurrë gur pa lëvizur", ka deklaruar Fury. "Unë gjithmonë bëj gjithçka që mundem për të qenë i suksesshëm. Mënyra se si e shikoj është, nëse ky djalë do të më mundë, atëherë do t'i shtrëngo dorën. Ai duhet të jetë një luftëtar i mirë, sepse unë nuk jam njeri i lehtë për t'u mposhtur siç e kam treguar gjatë viteve", ka shtuar Fury.

### SHKURT

#### Arsenali pa katër titullar ndaj Bournemouthit

Trajneri i Arsenalit, Mikel Arteta, nuk do të ketë në dispozicion të paktën katër futbollistë titullarë në ndeshjen që skuadra e tij do ta zhvillojë të shtunën ndaj Bournemouthit. Është vetë trajneri ai që konfirmoi mungesat. Fjala është për Declan Rice, Gabriel Martinelli, Leandro Trossard dhe Bukayo Saka, të cilët nuk janë stërvitur që nga derbi i Londrës veriore në fundjavën e kaluar kundër Tottenhamit (2-2). Kësaj liste i shtohen edhe Thomas Partey, Jurrien Timber dhe Fabio Vieira. Kjo do të thotë se trajneri duhet të ndërtojë sërish një ekip të ri, siç bëri të mërkurën, kur fitoi 1-0 ndaj Brentfordit në Kupë.

#### Eto'o akuzohet për kurdisje të rezultateve

Presidenti i Federatës së Futbollit të Kamerunit që nga dhjetori 2021, Samuel Eto'o, është subjekt i një hetimi. Ish-sulmuesi i Interit dhe Barcelonës, pas akuzave të ish-zëvendëspresidentit federal, po hetohet nga policia me akuzën se ka kurdisur ndeshjet e kategorisë së dytë për të ngjitur Victoria Unitedin në kategorinë e parë. Kështu shkruan "The Guardian". Sipas saj, personi në fjalë ka hedhur poshtë të gjitha akuzat. Gazeta e njohur britanike raporton se hetimi do të jetë më i gjerë dhe do ta prekë të gjithë federatën, që nga momenti kur në krye të saj u vendos ish-sulmuesi i Barcelonës. Ky hetim mund të përfshijë deri në 40 persona.

#### Mourinho: Është fillimi më i keq në karrierën time

Trajneri Jose Mourinho është munduar të arsyetohet pasi Roma pësoi humbje të thellë nga Genoa me rezultat 1-4. Trajneri portugez ka theksuar se është fillimi më i keq në karrierën e tij por që, sipas tij, Roma luajti dy finale evropiane radhazi falë tij. "Është fillimi më i keq në karrierën time. Megjithatë, mendoj se është hera e parë që Roma luan dy finale evropiane radhazi", u shpreh Mourinho. "Është skuadra që kemi dhe me këtë skuadër duhet të dalim nga kjo situatë. Nuk ka më afat transferimi. Askush nuk mund të largohet apo të arrijë. Ky është grupi që kemi me cilësitë dhe problemet e tij. Nuk kemi kohë për të qarë. Mund të qajmë nga brenda, sepse na dhemb zemra, veçanërisht për mua për shkak të raportit tim me tifozët e Romës. Por do t'i kthehem punës. Ndeshja tjetër vlen tri pikë, jo shtatë apo tetë, por bëhet një ndeshje shumë, shumë e rëndësishme për ne", ka deklaruar Mourinho.

#### Ten Hagen e ka besimin e Unitedit

Drejtuesit e Manchester Unitedit janë të kënaqur me punën e Erik ten Hag, edhe pse ky sezon nuk ka nisur shumë mirë. "Djajtë e Kuq" renditen pas javës së gjashtë në vendin e nëntë në Premierligë me 9 pikë të grumbulluara. Tri fitore dhe po kaq humbje për Unitedin, që dështoi edhe në sfidën e parë të fazës së grupeve në Ligën e Kampionëve kundër Bayern Munchenit. Gjithsesi, optimizmi në kampin e kuq është i madh dhe besimi kundrejt teknikut holandez është i palëkundur. Drejtuesit po përgatitin rinovimin me Ten Hag, të cilin duan të mbajnë gjatë në "Old Trafford". 53-vjeçari ka kontratë deri më 2025, por tek Unitedi duan ta zgjatnin më shumë bashkëpunimin me të. Një vendim që konfirmon pozitat e palëkundura të trajnerit, por edhe një mesazh i qartë për lojtarët që nuk kanë marrëdhënie të mirë me të si Sancho.

## Reali nuk synon vetëm Mbappen, por edhe Sonin

Real Madridi nuk po planifikon vetëm transferimin e Kylian Mbappes nga PSG-ja, por edhe kapitenit të ri të Tottenham Hotspurit, Son Heung-Min. 31-

vjeçari korean është pjesë e Tottenhamit prej vitit 2015, derisa ka kontratë deri në vitin 2025, kurse ka shënuar 5 gola deri tani në Premierligë, duke e

ndihmuar skuadrën të bëjë mirë dhe të sigurojë rezultate pozitive. Vetë Son shpreson të luajë një ditë me skuadrën më të titulluar në Evropë. Shumë

vite në ishull me Tottenhamin dhe vetëm dy finale të humbura (Champions+Carabao). Son dëshiron të fitojë trofe dhe Reali është mundësia më e

mirë për ta bërë. Gjithsesi, arritja e akordit me presidentin Daniel Levy nuk do të jetë një mision i lehtë për spanjollët.

ATK 148/2023  
1 29.09.2023



Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosovo  
Qeveria – Vlada – Government  
Ministria e Financave – Ministarstvo za Finansije – Ministry of Finance  
Administrata Tatimore e Kosovës – Poreska Administracija Kosovo – Tax Administration of Kosovo



### NJOFTIM I SHITJES ME OFERTA TË MBYLLURA OBAVEŠTENJE O PRODAJI SA ZATVORENIM PONUDAMA

Sipas Ligjit Nr. 03/L-222 Neni 34, pasuria e përshkruar më poshtë është konfiskuar për mos pagesë të tatimit, nga Mbledhja e Detyrueshme.

Prema Zakonu br. 03/L-222 Član 34, dole opisana imovina je konfiskovana od strane Prinudne naplate poreza zbog neplaćanja poreza.

Pasuria do të shitet me ankand të ofertave të mbyllura sikurse është rregulluar me Ligjin 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat dhe Udhëzimin administrativ nr. 15/2010, neni 37.

Imovina će se prodati putem aukcije zatvorenih ponuda kao što je regulisano "Zakon 03/L-222 o poreskoj administraciji i procedurama" član 34 i Administrativno uputstvo br. 15/2010, član 37.

Ofertat do të hapen/ Ponude će biti otvorene: Për herë të dyte me datën 09.10.2023 ne ora 10/ drugi put 09.10.2023 u 10 časova

Vendi i shitjes/ Prodajno mesto: Zyra e Atk - Departamenti i mbledhjes së borxheve - Veternik (prapa Albi mall): PAK kancelarije – Odeljenje za naplatu dugova - Veternik (iza Albi tržnog centra)

#### Përshkrimi i pasurisë/Opis imovine:

1.Parcellë tokë Bujqësore (Arë e klasës 4) Njesia kadastrale me numer parcelle P-72809072-01010-9 pron private me sipërfaqe 1228 m2 posedim individual 1/1 te vendi i quajtur Udhë e Lugut fshati: Gllavic- Rashincë Komuna Shtime./Poljoprivredna parcela (njiva 4 klase) katastarska jedinica sa parcelom broj P-72809072-01010-9 privatna svojina sa površinom od 1228 m2 individualna svojina 1/1 na mestu zvanom Lugski put, selo Glavic-Rašinka, opština Štimlje.

2.Parcellë tokë Bujqësore (Arë e klasës 4)Njesia kadastrale me me numer parcelle P-72809072-01010-19 pron private me sipërfaqe 101m2 posedim 1/1 te vendi i quajtur Udhë e Lugut fshati Gllavic- Rashincë Komuna Shtime./ Poljoprivredna parcela zemljišta (njiva 4 klase) katastarska jedinica sa parcelom broj P-72809072-01010-19 privatna svojina površine 101m2, posedovanje 1/1 zemljišta pod nazivom Lugski put, selo Glavic-Rašinka, opština Štimlje

3.Parcellë tokë Bujqësore (Arëe klasës 4)Njesia kadastrale me me numer parcelle P-72809072-01010-18 pron private me sipërfaqe 1607m2 posedim 1/8 te vendi i quajtur Udhë e Lugut fshati Gllavic- Rashincë Komuna Shtime./Poljoprivredna parcela (njiva 4 klase) katastarska jedinica sa parcelom broj P-72809072-01010-18 privatna svojina površine 1607m2, posedovanje 1/8 zemljišta pod nazivom Lugski put, selo Glavic-Rašinka, opština Štimlje.

Çmimi fillestarë (hera te dyte)/Cena u drugoji prodaj

Çmimi fillestarë (hera e dyte): P-72809072-01010-9 është 420€ për një ari / Početna cena parcele: P-72809072-01010-9 je 700€ za jedan ar

Çmimi fillestarë (hera e dyte): P-72809072-01010-19 është 420€ për një ari / Početna cena parcele: P-72809072-01010-19 je 700€ za jedan ar

Çmimi fillestarë (hera e dyte): P-72809072-01010-18 është 420€ për një ari/ Početna cena parcele: P-72809072-01010-18 je 420€ za jedan ar

**Kushtet e pjesëmarrjes:** Kushti i pjesëmarrjes në ankand, kur kemi shitje të pasurisë së paluajtshme është paradhënia (garancioni bankar) në shumën 10%( minimumi) të detyrimeve tatimore të pa paguara të tatimpaguesit.

Uslov učešća na aukciji; kada prodajemo nepokretnosti, je akontacija (bankarska garancija)u iznosu od 10% neizmirenih poreskih obaveza poreskog obveznika.

**Paraqitja e Ofertave:** Të gjitha ofertat qartë duhet të identifikojnë pasurin e ofruar, shumën e ofertës, emrin, adresën dhe numrin e llogaris bankare të individit apo entitetit që paraqet ofertën, Ofertat duhet të pranohen në pliko (zarf) të mbyllur përpara datës dhe kohës të specifikuar më lartë.

**Dostavljanje ponuda:** Sve ponude moraju jasno da identifikuju ponudenu imovinu, iznos ponude, ime, adresu i broj bankovnog računa fizičkog ili pravnog lica koje podnosi ponudu. Ponude moraju biti primljene u zatvorenoj kovrti pre navedenog datuma i gorepomenutog roka.

**Kushtet e pagesës,** Kërkohet pagese e tërësishme dhe e menjëhershme.

**Pasuria mund të inspektohet:** nga data 27.09.2023 deri me datën 29.09.2023 nga ora 09 deri 15  
**Nekretnina se moze razgledati:** od datum 27.09.2023 do 29.09.2023 od 09 do 15 sati

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i zyrtarit të mbledhjes/Ime, prezime i službenik naplate:

Islam Hasani - Hasani  
Data / Date/ Datum: 29.09.2023



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Financave dhe Transfereve - Ministarstvo za Finansije i Transfere - Ministry of Finance and Transfers  
Administrata Tatimore e Kosovës – Poreska Administracija Kosovo - Tax Administration of Kosovo



### NJOFTIM I SHITJES ME OFERTA TË MBYLLURA OBAVEŠTENJE O PRODAJI SA ZATVORENIM PONUDAMA

Sipas Ligjit Nr. 03/L-222 Neni 34, pasuria e përshkruar më poshtë është konfiskuar për mos pagesë të tatimit, nga Mbledhja e Detyrueshme.

Prema Zakonu br. 03/L-222 Član 34, dole opisana imovina je konfiskovana od strane Prinudne naplate poreza zbog neplaćanja poreza.

Pasuria do të shitet me ankand të ofertave të mbyllura sikurse është rregulluar me Ligjin 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat dhe Udhëzimin administrativ nr. 15/2010, neni 37.

Imovina će se prodati putem aukcije zatvorenih ponuda kao što je regulisano "Zakon 03/L-222 o poreskoj administraciji i procedurama" član 34 i Administrativno uputstvo br.15/2010,član 37.

**OFERTA DO TË HAPET / PONUDE ĆE SE OTVORITI:**20.10.2023 Për herë të dyte/drugi put.

**KOHA/VREME:** 10:00

**VENDI/MESTO:** Zyra e ATK/Kancelarije PAK – Departamenti i mbledhjes se borxheve – Veternik /Odeljenje naplate dugova-Veternik

#### Përshkrimi i pasurisë/Opis imovine:

Gjindet në fshatin Tërpezë të Malishevës /Celokupna imovina je na ime nalazi se u selu Terpeze u Mališevu.

Parcela/Parcela – P-72310075-01972-0

Parcela /Parcela- P-72310075-01973-1

Parcela/Parcela – P72310075-01973-2

Parcela /Parcela- P72310075-01973-3

Bager/Bager

Gjenerator/Generator

Kompjuter/Kompjuter

#### Çmimi fillestar i shitjes (hera e dyte)/Početna prodajna cena:

Çmimi fillestare për Parcela/Početna cena za parcelu-P-72310075-01972-0, P-72310075-01973-1, P72310075-01973-2, P72310075-01973-3 - 150.000 Euro/evra

Çmimi fillestare për Bager /Početna cena za bager - 9.000 Euro

Çmimi fillestare për Gjenerator/ Početna cena za gjenerator- 6.000 Euro

Çmimi fillestare për Kompjuter/ Početna cena za kompjuter – 120 Euro

**Parcelat e përshkruara shiten ne tërësi, dmth nuk shiten ndaras, ndërsa pjesët tjera shiten ndaras! / Opisane parcele se prodaju u celini, odnosno ne prodaju se posebno, dok se ostali delovi prodaju posebno!**

**Kushtet e pjesëmarrjes:** Kushti i pjesëmarrjes në ankand, kur kemi shitje të pasurisë së paluajtshme është paradhënia (garancioni bankar) në shumën 10%( minimumi) të detyrimeve tatimore të pa paguara të tatimpaguesit.

**Uslovi učešća na aukciji;** Uslov učešća na aukciji kada prodajemo nepokretnosti, je akontacija (bankarska garancija) u iznosu od 10% neizmirenih poreskih obaveza poreskog obveznika.

**Paraqitja e Ofertave:** Të gjitha ofertat qartë duhet të identifikojnë pasurin e ofruar, shumën e ofertës, emrin, adresën dhe numrin e llogaris bankare të individit apo entitetit që paraqet ofertën, Ofertat duhet të pranohen në pliko (zarf) të mbyllur përpara datës dhe kohës të specifikuar më lartë.

**Dostavljanje ponuda:** Sve ponude moraju jasno da identifikuju ponudenu imovinu, iznos ponude, ime, adresu i broj bankovnog računa fizičkog ili pravnog lica koje podnosi ponudu. Ponude moraju biti primljene u zatvorenoj kovrti pre navedenog datuma i gorepomenutog vremena.

**Kushtet e pagesës,** Kërkohet pagese e tërësishme dhe e menjëhershme./Uslovi plaćanja, potrebno je potpuno i blagovremeno plaćanje.

**Pasuria mund të inspektohet:** Nga data 09.10.2023 deri 19.10.2023 nga ora 09:00 deri 15:00

**Nekretnina se može pogledati:** od dana 09.10.2023 do 19.10.2023 od 09:00 do 15:00 sati

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i zyrtarit të mbledhjes/ Ime, prezime i službenik naplate:

Beldar Lenca  
Data/Dana: 29.09.2023

ATK 153/2023  
1 28.09.2023

**Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
Qeveria – Vlada – Government  
Ministria e Financave – Ministarstvo za Finansije – Ministry of Finance  
Administrata Tatimore e Kosovës – Poreska Administracija Kosovo – Tax Administration of Kosovo

**NJOFTIM I SHITJES ME OFERTA TË MBYLLURA  
OBAVEŠTENJE O PRODAJI SA ZATVORENIM PONUDAMA**

Sipas Ligjit Nr. 03/L-222 Neni 34, pasuria e përshkruar më poshtë është konfiskuar për mos pagesë të tatimit, nga Mbledhja e Detyrueshme.  
Prema Zakonu br. 03/L-222 Član 34, dole opisana imovina je konfiskovana od strane Prinudne naplate poreza zbog neplaćanja poreza.

Pasuria do të shitet me ankand të ofertave të mbyllura sikurse është rregulluar me Ligjin 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat dhe Udhëzimin administrativ nr.15/2010, neni 37.  
Imovina će se prodati putem aukcije zatvorenih ponuda kao što je regulisano "Zakon 03/L-222 o poreskoj administraciji i procedurama" član 34 i Administrativno uputstvo br. 15/2010, član 37.

**OFERTA DO TË HAPET/PONUDE ĆE SE OTVORITI:** 16.10.2023 Për herë të dyte/Prvi put.  
**KOHA/VREME:** 10:00  
**VENDI/MESTO:** Zyra e ATK/Kancelarije PAK – Departamenti i mbledhjes së borxheve –Veterinik /Odeljenje naplate dugova-Veterinik

**Përshkrimi i pasurisë/Opis imovine:**  
Pasuria, gjegjësisht 3 lokalet të cilat janë në shitje janë /Imovina, odnosno 3 lokala koji se prodaju, su u vlasništvu

Pronësia e kesaj pasurie është fituar nga Kontrata për ndërtim të përbashkët me nr: LRP.nr.1370, Ref.nr.300/16 e lidhur me datën 04.05.2016. /Vlasništvo nad ovom imovinom je stečeno Ugovorom o zajedničkoj izgradnji broj: LRP.br.1370, Ref.br.300/16 od 04.05.2016.

Lokalet gjinden në objektin afaristo – banesor në parcelën me numër P-70403013-03860-1 zonë kadastrale Gjilan./Lokali se nalaze u poslovno-stambenoj zgradi u parceli broj P-70403013-03860-1 katastarske zone Gnjilane.

Lokali nr.1 gjindet në përdhës me sipërfaqe prej 345 m2/ Lokal broj 1 se nalazi u prizemlju sa površinom od 345 m2  
Lokali nr.3 gjindet në katin 1 me sipërfaqe prej 107 m2/ Lokal broj 3 se nalazi na 1. spratu površine 107 m2  
Lokali nr.5 gjindet në katin 1 me sipërfaqe prej 220 m2 /Lokal broj 5 se nalazi na 1. spratu površine 220 m2

**Çmimi fillestarë i shitjes/ Početna prodajna cena:**

Çmimi fillestar për lokalin nr.1 është 1080-euro për m2/ Početna cena lokala broj 1 je 1080 evra po m2  
Çmimi fillestar për lokalin nr.3 është 780-euro për m2 /Početna cena lokala broj 3 je 780 evra po m2  
Çmimi fillestar për lokalin nr.5 është 720-euro për m2/Početna cena lokala broj 5 je 720 evra po m2

**Kushtet e pjesëmarrjes:** Kushti i pjesëmarrjes në ankand, kur kemi shitje të pasurisë së paluajtshme është paradhënia (garancioni bankar) në shumën 10%( minimumi) të detyrimeve tatimore të pa paguara të tatimpaguesit.  
**Uslovi učešća:** uslov učešća na licitaciji, kada prodajemo nepokretnosti, je akontacija (bankarska garancija) u iznosu od 10% neizmirenih poreskih obaveza poreskog obveznika


**Paraqitja e Ofertave:** Të gjitha ofertat qartë duhet të identifikojnë pasurinë e ofruar, shumën e ofertës, emrin, adresën dhe numrin e llogaris bankare të individit apo entitetit që paraqet ofertën, Ofertat duhet të pranohen në pliko (zarf) të mbyllur përpara datës dhe kohës të specifikuar më lartë.  
**Dostavljanje ponuda:** Sve ponude moraju jasno da identifikuju ponudenu imovinu, iznos ponude, ime, adresu i broj bankovnog računa fizičkog ili pravnog lica koje podnosi ponudu. Ponude moraju biti primljene u zatvorenoj kovrti pre navedenog datuma i gorepomenutog roka.

**Kushtet e pagesës,** Kërkohej pagese e tërësishme dhe e menjëhershme./ Uslovi plaćanja, potrebno je potpuno i blagovremeno plaćanje.

**Pasuria mund të inspektohet:** Nga data 28.09.2023 deri 13.10.2023 nga ora 09:00 deri 15:00/Imovina se može pogledati: od dana 28.09.2023 do 13.10.2023 od 09:00 do 15:00 časova.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i zyrtarit të mbledhjes/Ime, prezime i službenik naplate:  
*Sabri Dermula*

Data/dana: 28.09.2023



# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

[www.facebook.com/gjeipuneshpeite](http://www.facebook.com/gjeipuneshpeite)

## RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

**Lume's Details**

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

*Qeveria - Vlada - Government*  
**MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË**  
**AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIMIN PROFESIONAL DHE ARSIMIN PËR TË RRITUR**  
**AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSLOVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE**  
**AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION**



Numër: 1014 /1  
Datë: 29.09.2023

Agjencia e Arsimit dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimit për të Rritur (AAAPARr), në bazë të nenit 13 dhe 34 të Ligjit të Arsimit dhe Aftësimin Profesional (Gaz. Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 7/26 Mars), në bazë të Ligjit Nr. 04/1-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Udhëzimit Administrativ nr. 05/2012, Udhëzimit Administrativ nr. 14/2014, Udhëzimit Administrativ nr. 02/2016, si dhe në bazë të kërkesës së Qendrës së Kompetencës në Skenderaj shpall:

## Ftesë për ofertë

**Për ekskursion të maturanëve të shkollës Mesme të Qendrës së Kompetencës në Skenderaj, në Republikën e Shqipërisë**

**Ftojme ofertuesit e kualifikuar (Agjencionet turistike organizatore të udhëtimit) që të paraqesin ofertat e tyre në zarf të mbyllur.**

**Agjencionit turistik duhet t'i plotësojë këto parakushte:**

**Agjencioni ose kompania duhet t'i plotësojë këto parakushte:**

- Regjistrimi në regjistrin profesional të ndërmarrjeve (Certifikata e biznesit).
- Certifikata e TVSH-së;
- Të jetë i licencuar sipas procedurave ligjore;
- Dëshmia e kontrollit teknik të automjetit sipas procedurave ligjore, dhe të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e shkollës;
- Autobusët të jenë komfor dhe me klimë;
- Agjencioni duhet të ketë dëshmi për shëndetin fizik dhe mendor të ngasësve të autobusit;
- Agjencioni duhet të ketë të pajisur shoferët me kompetencën profesionale (CPC)
- Certifikata e autobusit sipas Licencës "D";
- Agjencioni duhet të sigurojë përkujdesje mjekësore për nxënës dhe dëshmi (Certifikatë pune dhe diplomë të mjekut) që shoqëron nxënësit;
- Lloji i transportit (Autobus);
- Viti i prodhimit të autobusëve;
- Agjencionit turistik duhet të ketë dokumentacionin (licencën) e agjencionit të akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve;
- Agjencionit duhet të ketë një para kontratë për rezervimin e hotelit me data të caktuara nga KDSH-ja në Durrës 2023;
- Kategorizimi i hoteleve në bazë të yjeve;
- Agjencionit duhet të prezantohet dëshmi: menynë ditore të plotë për secilën ditë të ekskursionit;
- Agjencionit turistik duhet t'i përmbahet itinerarit të cilin e ka përcaktuar Këshilli Drejtues i shkollës;
- Agjencionit duhet të garantojë me dëshmi (deklaratën nën betim nga OE), se do t'i mbulojë të gjitha shpenzimet gjatë vizitave në monumentet kulturo-historike;
- Agjencionit duhet të na ofrojë siguri (deklaratë nën betim nga OE), në hotele dhe gjatë vizitave që do tu bëhen monumenteve kulutor-historike;
- Agjencionit do të ofrojë dëshmi për qarkullimin financiar nga banka për dy vitet e fundit (2021-2022) në vlerë prej 95,000 euro (nëntëdhjetë e pesë mijë euro);
- Agjencionit duhet të ofrojë një listë me emrat e shoferëve që do të marrin pjesë në ekskursion, kategorinë e patentë shoferit, llojin e autobusit, vitin e prodhimit, numrin e ulëseve dhe targat e autobusit që do të vozisin;
- Agjencionit duhet të ofrojë listën e shoferëve dhe punëtorëve të deklaruar në ATK, që do të marrin pjesë në ekskursion.

**Kushtet tjera:**

- **Nisja duhet të bëhet më dt.06.10.2023 dhe kthimi më dt.10.10.2023-që i bije se duhet të kalohen katër netë akomodimi.**
- Një deklaratë e shkruar nën betim, e nënshkruar nga tenderuesi;
- Dëshmi (origjinale, kontratë) mbi rezervimin e hoteleve sipas ofertës;
- Dëshmi mbi sigurimin e ekzekutimit, të kontratës në vlerë prej 10%, të vlerës së kontratës;
- Të sigurohet pasioni i plotë. Gjatë udhëtimit nëpër qytete racioni i rregullt mund të zëvendësohet me ushqim të thatë.
- Në të shkuar, gjatë rrugës ushqim çasti të mëngjesit dhe pije, ndërsa darkën në Durrës. Në të kthyer darkë cilësore dhe në kohë normale.

- Agjencionit të merr përsipër pagesën e vizitave monumenteve kulturo historike
- Të ketë komoditet gjatë udhëtimit (autobusë me kondicioner).
- Mundësi vizite në qytetet: Krujë, Tiranë, Durrësi i vjetër, Berat, Shkodër
- Vërtetimi i ATK-së i cili ka vlefshmëri
- Vërtetimi i taksave komunale për vitin 2022
- Vërtetimi i tatimit në pronë për vitin 2022

**Vlerësimi i ofertave:**

Hapja e ofertave bëhet nga komisioni sipas UA 02/2016 në ambientet e Shkollës

Kriter për përzgjedhjen e kompanisë turistike do të jetë oferta më e përshtatshme ekonomike:

- Çmimi i ofertës
- Lloji i Hotelit (kategorizimi i hoteleve në bazë të yjeve, nr. i nxënësve nëpër dhoma etj)
- Menyja
- Numri i nxënësve që udhëtojnë falas
- Gjendja teknike e autobusëve numri, dhe viti i prodhimit të autobusëve
- Numri i referencave

Pas vlerësimit të ofertave nga komisioni, publikimi i përfutuesit do të shpallet pasdite në tabelën e shpalljeve në shkollë, pasdite në të njëjtën ditë.

Ofertuesit e interesuar ofertat e kompletuara me dokumentacionin e kërkuar t'i dorëzojnë në AAAPARr, ndërtesa e MASHTI-it nr. II (përballë Fakultetit Ekonomik), kati i III në Prishtinë sipas orarit 08:00-15:00.

Hapjen e ofertave e bën Komisioni sipas Udhëzimit Administrativ nr. 02/2016.

Përparësi në shqyrtimin e ofertave nga ana e komisionit do të kenë Agjencionet turistike që e kanë të kompletuar ofertën dhe që i plotësojnë kriteret e caktuara nga KDSH-ja.

Kriter për përzgjedhjen e kompanisë turistike do të jetë oferta më e përshtatshme ekonomike.

Agjencia e Arsimit dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimit për të Rritur mban të drejtën për anulimin e ofertës.

Data e nisjes mund të ndryshojë (plus-minus dy ditë), ndërsa agjenda mund të ndërrojë varësisht nga kërkesa e udhëheqësit të ekskursionit.

**Afati i paraqitjes së ofertave është shtatë (7) ditë nga dita e shpalljes në gazetë dhe në tabelën e shpalljeve në Shkollë dhe AAAPARr, hapja dhe vlerësimi i ofertave bëhet në ditën e mbylljes së konkursit në ambientet e AAAPARr-së.**

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Leart Krasniqi shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - V shfmu "Bajram Curri", Krushe e Madhe.

- Edi Xhezairi shpall të pavlefshme diplomën , dëftesat, certifikatën shne "Ymer Prizreni" Prizren.

- Kemajl Beka shpall të pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën e shkollës së mesme "Arkitekt Sinani" ish shkolla "Boris Kidric".

- Sara Ibishi shpall te pavlefshme dëftesat diplomën e shkollës së mesme të lartë "Xheladin Deda".

- Muhamet Kurta shpall të pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën e shkollës së mesme "Arkitekt Sinani" ish shkolla "Boris Kidric".

- Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

